AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

# RAPORT I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në:**

**"EU Business Law"**

**Universiteti i Tiranës**


**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:**

**Dr. Blerina Shkurti Masha**

**Dr. Dorina Gjipali**


**Qershor / 2023**

## TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

**Master Profesional në: "EU BUSINESS LAW"**

| | | |
|---|---|---|
| 1 | IAL aplikues: | Universiteti i Tiranës |
| 2 | Njësia bazë që e ofron: | Departamenti i së Drejtës Publike<br>Departamenti i së Drejtës Civile<br>Departamenti i së Drejtës Penale |
| 3 | Emërtimi i programit të studimit: | Master Profesional në: "EU BUSINESS LAW" |
| 4 | Urdhri/VKM i licencimit: | VKM Nr. 802, datë 22.07.2009 ndryshuar me VKM 1051, datë 23.10.2009 |
| 5 | Urdhri/VKM i riorganizimit: | - |
| 6 | Urdhëri i regjistrimit të Formës së diplomës | Urdhër i MASH Nr. 297, datë 20.07.2012 |
| 7 | Urdhri/VBA i akreditimit të parë: | - |
| 8 | Cikli i studimit: | Cikli II |
| 9 | Kohëzgjatja e programit të studimit: | 1 vit akademik |
| 10 | Kreditet në total (ECTS): | 60 ECTS |
| 11 | Forma e studimit: | Me kohë të plotë |
| 12 | Gjuha (shqip/tjetër): | Shqipe |
| 13 | Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera: | - |
| 14 | Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin): | - |
| 15 | Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin): | - |
| 16 | Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve: | 7 |
| 17 | Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit | 12 PAE / 0 PAK |
| 18 | Numri i studentëve: | 2020-2021 – 81 studentë<br>2021-2022 – 54 studentë<br>2022-2023 – 40 studentë |

## TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti i Tiranës (UT) është një institucion publik i arsimit të lartë, i themeluar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.207 dt.30.05.1957. UT-së i është akorduar akreditimi institucional me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 4, datë 27.01.2023, me kohëzgjatje 6 vite akademike, me afat vlefshmërie deri më 26.01.2029. Universiteti i Tiranës sipas strukturës aktuale ka në përbërjen e tij një filial, gjashtë fakultete dhe dy institute emërtuar si vijon:

1. Filiali i Sarandës
2. Fakulteti i Gjuhëve të Huaja
3. Fakulteti i Ekonomisë
4. Fakulteti i Drejtësisë
5. Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë
6. Fakulteti i Shkencave Sociale
7. Fakulteti i Shkencave të Natyrës
8. Instituti i Fizikës Bërthamore
9. Instituti i Studimeve Evropiane

Fakulteti i Drejtësisë, si një nga njësitë kryesore të tij dhe në të cilën ofrohet programi Master Profesional në "European Business Law", e ushtron veprimtarinë e tij akademike dhe shkencore në funksion të konsolidimit të vlerave akademike kombëtare në fushën e drejtësisë me fokus në të drejtën e BE-së.

Programi i studimit Master Profesional "European Business Law", është program i ciklit të dytë të studimeve licensuar me VKM nr. 802, datë 22.7.2009, ndryshuar me VKM 1051, datë 23.10.2009 i cili ofrohet nga Fakulteti i Drejtësisë si bashkëpunim ndërmjet tre njësive bazë të këtij fakulteti, Departamenti i të Drejtës Civile, Penale dhe Publike, si njësi përgjegjëse për ofrimin dhe realizimin e procesit akademik dhe shkencor të këtij masteri.

Masteri Profesional "European Business Law", fillimisht ka qenë pjesë e një konsorciumi rajonal të mbështetur nga Fondi i Hapur Rajonal GTZ për Europën Juglindore, si pjesë e një masteri rajonal me lektorë vendas e të huaj dhe një pjesë e lëndëve u ofrua në gjuhën angleze. Aktualisht struktura akademike bashkëpunuese për këtë program studimi janë Departamenti i të Drejtës Civile, Penale dhe Publike të Fakultetit të Drejtësisë.

Aktualisht programi organizohet me 60 ECTS, dhe kohëzgjatja e tij normale është 1 vit akademik. Nga të dhënat e siguruara nga Sekretaria Mësimore e FD rezulton se në studentët e regjistruar në këtë program studimi në vitet e fundit akademike janë si më poshtë vijon:

- Viti akademik 2019-2020 – 74 studentë
- Viti akademik 2020-2021 – 81 studentë
- Viti akademik 2021-2022 – 54 studentë
- Viti akademik 2022-2023 – 40 studentë

## PËRSHKRIM I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Procesi i vlerësimit të jashtëm për akreditimin e programit të studimit Master Profesional në "European Business Laë", ofruar nga Departamentet e Fakultetit të Drejtësisë pranë Universitetit të Tiranës filloi me prezantimin si dhe ndarjen e punës ndërmjet ekspertëve të grupit të vlerësimit të jashtëm. Më pas ky grup, bazuar në dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga ASCAL, filloi shqyrtimin e Raportit të vlerësimit të brendshëm si dhe dokumentet përkatëse në mbështetje të tij. Gjatë kësaj faze u identifikuan dhe u listuan një sërë pyetjesh, që kishin lidhje me standardet dhe kriteret përkatëse, të cilat do të merrnin përgjigje gjatë takimeve që do të realizoheshin në IAL.

ASCAL bazuar në "*Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017*", ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga UT, për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm.

Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje: Dr. Blerina Shkurti Masha dhe Dr. Dorina Gjipali. Gjatë gjithë procesit ky grup pune u asistua dhe nga menaxheri teknik i ASCAL, Znj. Majlinda Demirneli. Vizita 2 ditore në Universitetin e Tiranës u realizua gjatë datave 30 dhe 31 Janar 2023, ku Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, realizoi takimet e përcaktuara sipas axhendës së vizitës në IAL.

Gjatë vizitës në institucion u realizuan takime me drejtues të njësisë kryesore si Dekanin e Fakultetit te Drejtesise, Zv Dekanin përgjegjës për këtë program studimi, drejtues të njësive bazë, me Grupin e Vlerësimit të Brendshëm, stafin akademik, studentë, punonjësit e sekretarisë mësimore. Gjithashtu u bë vizitë në mjediset mësimdhënëse të këtij universiteti dhe në bibliotekën e universitetit. Angazhimi dhe bashkëpunimi i drejtuesve të FD për ofrimin e informacionit të kërkuar ishte serioz. Pothuajse të gjitha kërkesat e anëtarëve të grupit, lidhur me vënien në dispozicion të dokumentacionit u plotësuan menjëherë. Ky raport konsiston në vlerësimin e jashtëm të programit të studimit Master Profesional në "EU Business Law"

Universiteti i Tiranës është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 23.05.2023, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 1/93 Prot, datë 23.05.2023. Universiteti i Tiranës nuk ka dërguar komente, sugjerime në lidhje mbi Draft Raportin, sipas Manualit 2017, si dhe përcaktimit në agjendën e detajuar të vlerësimit. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

## I. OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT

| **Standardi I.1**<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi të ciklit të dytë "Master profesional" në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1** Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare. | Bazuar në dokumentacionin e dosjes së vetëvlerësimit (DVV) si dhe gjetjeve gjatë vizitës në institucion, GVJ arrin në gjykimin se programi i studimeve i Ciklit të dytë MP në "European Business Law"," i ofruar nga i Departamentet e Fakultetit të Drejtësisë, në të gjithë komponentët e tij nuk bie ndesh me interesat kombëtare por i shërben këtyre të fundit.<br><br>FD ofron programe studimi të ciklit të dytë (DIND) një program studimi, "Master i Shkencave" (3 programe studimi), "Master Profesional" (4 programe studimi) dhe programe të ciklit të tretë të studimit "Master Ekzekutiv" (1 program studimi). Këto programe studimi janë në përputhje me interesat kombëtarë dhe përputhje me nevojat e tregut të punës.<br><br>*Evidenca nr. 2 "Statuti i Universitetit të Tiranës"* |
| **Kriteri 2** Programet e studimit synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. | Nga shqyrtimi i statutit të Universitetit të Tiranës dhe Planit Strategjik të tij, GVJ vlerëson se programet e studimit, përfshirë programin MP ne "European Business Law", synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. Ndër të tjera Universiteti i Tiranës synon t'u japë studentëve një edukim cilësor të qëndrueshëm, t'i shërbejë dijes së shoqërisë shqiptare me anë të mësimdhënies, kontributit në kërkim, përdorimit të arritjeve më të mira të dijes dhe të shkencës si dhe partneriteteve me tregun e punës dhe atyre ndërkombëtare. Departamentet e FD si njësi përgjegjëse për ofrimin dhe realizimin e procesit akademik dhe shkencor të këtij masteri, ishin fillimisht pjesë e një konsorciumi rajonal të mbështetur nga Fondi i Hapur Rajonal GTZ për Europën Juglindore. Ky master u krijua si pjesë e një masteri rajonal me lektorë vendas e të huaj dhe një pjesë e lëndëve u ofrua në gjuhën angleze. Aktualisht struktura akademike |

| | |
|---|---|
| | bashkëpunuese për këtë program studimi janë Departamenti i të Drejtës Civile, Penale dhe Publike, FD, UT.<br><br>*Evidenca nr. 2 "Statuti i Universitetit të Tiranës" ;*<br>*Evidenca nr.6 "Strategjia institucionale për mësimdhënien – UT 2022-2027";*<br>*Evidenca nr. 4"Strategjia e Zhvillimit të Universitetit të Tiranës 2018-2023";*<br>*Evidenca nr.7 "VKM-të Për hapjen e Masterit;* |
| **Kriteri 3** Programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë. | Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se programi studimit MP në "European Business Law" është hartuar në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe me politikat e zhvillimit të Institucionit, në lidhje me përgatitjen e profesionistëve në fushën e të drejtës së biznesit.<br><br>*Evidenca nr. 2 "Statuti i Universitetit të Tiranës";*<br>*Evidenca nr. 4 "Strategjia e Zhvillimit të Universitetit të Tiranës 2018-2023".* |
| **Kriteri 4** Programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar. | Qëllimi i këtij programi është që të përgatisë dhe kualifikojë studentët me dije të thelluara në fushën e të drejtës së biznesit, të aftë të ofrojnë këshillim dhe përfaqësim në këtë fushë, t'u mundësojë atyre organizimin si subjekt i veçantë i ushtrimit të një profesionit të lirë që u ofron shërbime juridike për subjekte të ndryshme tregtare; të mbështesë specialistët shqiptarë, të jenë të aftë t'i përgjigjen kërkesave të reja, që anëtarësimi i Shqipërisë në BE kërkon si dhe zhvillojnë aftësitë analizuese e kërkimore, për t'u angazhuar në veprimtarinë studimore |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi I.2**<br><br>**Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të | GVJ konstaton se programi i studimit, është konceptuar në harmoni me strategjinë e institucionit i cili ka si objektiva strategjik, midis te tjerash, cilësinë dhe performancën akademike, kërkimin shkencor dhe inovacionin si dhe reformën kurrikulare në dy drejtime rishikimi i kurrikulave ekzistuese dhe hapja i kurrikulave të reja. |

| | |
|---|---|
| strategjisë për zhvillim të vetë institucionit. | Programi i studimit "Master Profesional European Business Law" zhvillohet në përputhje me një ndër objektivat strategjike të UT-së: *kombinimi i mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, në çdo program studimi që ofrohet në ciklin e dytë dhe të tretë të studimeve dhe aplikimin e tij kryesisht në programet e masterave ndërdisiplinorë.* (fq. 3).<br><br>*Evidenca nr. 4 "Strategjia e Zhvillimit të Universitetit të Tiranës 2018-2023".* |
| **Kriteri 2.** Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimet prioritare akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit. | Programi i studimit "Master Profesional European Business Law" është në përputhje me Strategjinë e Zhvillimit Institucional të UT-së 2018-2023, në bazë të së cilës institucioni synon të orientojë studentët drejt të menduarit analitik dhe ndërdisiplinor *(fq. 6).* Statuti i UT-së përcakton detyrimin për njësitë kryesore/bazë që të ofrojnë programe studimi që mundësojnë njohuri të thelluara në shkencat përkatëse, sipas drejtimeve të fushave të tyre akademike dhe shkencore.<br><br>*Evidenca nr. 2 "Statuti i Universitetit të Tiranës";*<br>*Evidenca nr.1 "Rregullorja e programit të studimit Master Profesional "European Business Law";* |
| **Kriteri 3.** Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit. | Programi i studimit MP në "European Business Law" ofron njohuri të thelluara teorike në fushën e të drejtës së Biznesit të BE-së. Programi i studimit në të drejtën e BE-së është një program ndërdisiplinor (bazuar dhe në strategjinë e zhvillimit të UT-së, *(fq. 7)* dhe përputhet me fushën e përgjithshme dhe specifike të fushave të studimeve që ofrohen nga Departamenti i të Drejtës Civile, Penale & Publike (si njësitë bazë përgjegjëse për këtë program studimi).<br><br>Hapja e këtij programi studimi është realizuar fillimisht përmes një konsorciumi rajonal të mbështetur nga Fondi i Hapur Rajonal, GTZ për Europën Juglindore. Ky master u krijua si pjesë e një masteri rajonal me lektorë vendas e të huaj dhe një pjesë e lëndëve u ofrua në gjuhën angleze.<br><br>*Evidenca nr.1 "Rregullorja e programit të studimit Master Profesional "European Business Law";*<br>*Evidenca 9 "Propozim per organizimin e programit të studimit "European Business Law";*<br>*Evidenca nr. 10 "Rregullorja e Brendshme për organizimin e programit rajonal të masterit për të drejtën e biznesit të BE-së";*<br><br>*Evidenca 14 "Mbi strukturën akademike në programin e studimit "Master Profesional European Business Law".* |

| | |
|---|---|
| | *Evidenca nr. 18.1 "Marrëveshja e bashkëpunimit për organizimin dhe zhvillimin e programit rajonal të masterit në të drejtën e biznesit të BE-së";* |
| **Kriteri 4.** Programet e studimit të ciklit të dytë "Master profesional" hartohen e zhvillohen në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit. | Programi i studimit Master Profesional në "European Business Law", është program i ciklit të dytë të studimeve i licensuar me VKM nr. 802, datë 22.7.2009 i ndryshuar me VKM 1051, dt. 23.10.2009 dhe ofrohet nga Fakultetin e Drejtësisë si bashkëpunim ndërmjet tre njësive bazë të këtij fakulteti (Departamenti i të Drejtës Civile, Penale dhe Publike). Ky program studimi është komform strategjisë kombëtare të zhvillimit në përafrimin e legjislacionit shqiptar me legjislacionin e BE.<br><br>*Evidenca nr. 4 "Strategjia e Zhvillimit të Universitetit të Tiranës 2018-2023".* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi I.3**<br><br>**Programet e studimit "Master profesional" synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me nevojat dhe kërkesat e tij.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Programet e studimit "Master profesional" kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës. | Programi i studimit Master Profesional "European Business Law", u mundëson studentëve që kanë përfunduar studimt Bachelor ose DIND në drejtësi dhe ekonomi të thellojnë njohuritë mbi legjislacionin në fushën e biznesit të BE-së. Ky master sheh nevojën në rritje për formim të thelluar teorik me qëllim aftësimin e studentit për një kërkim të pavarur didaktik në fushën e studimeve të së drejtës së BE-së.<br><br>*Evidenca nr.13 – "Informacion mbi programin e studimit"* |
| **Kriteri 2.** Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e | Ky program studimi është çelur në kuadër të një konsorciumi rajonal të mbështetur nga Fondi i Hapur |

| | |
|---|---|
| ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës. | Rajonal GTZ për Europën Juglindore, me lektorë vendas e të huaj. Aktualisht struktura akademike bashkëpunuese për këtë program studimi janë Departamenti i të Drejtës Civile, Penale dhe Publike, FD, UT.<br><br>Nga dokumentat e dorëzuara nga GVB *nuk rezulton që të jetë kryer një studim mbi tregun lokal dhe ndërkombëtar të punës për këtë program.*<br><br>*Evidenca nr. 8 – Memorandum mirëkuptimi për krijimin dhe zhvillimin e studimeve pasuniversitare për të Drejtësn e BE-së (dokument shqip)*<br>*Evidenca nr. 8.1 – The regional Master Programme on EU business Law – cooperation agreement for the organization and delivery of regional Master Programme on EU Business Law (dok anglisht)* |
| **Kriteri 3.** Objektivat formues struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit garantojnë përftimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve. | Ky Master synon të plotësojë kërkesën e të gjithë atyre të diplomuarve dhe profesionistëve që synojnë të plotësojnë njohuritë dhe kompetencat e tyre nga këndvështrimi i BE-së si dhe mundëson zgjerimin e dijeve në fushën e legjislacionit tregtar, vendas dhe evropian, duke i mëshuar aspekteve praktike të mësimnxënies në këtë fushë.<br><br>Programi ofron një shumëllojshmëri lëndësh nga fusha e të drejtës së biznesit, të cilat kanë për qëllim të ndihmojnë, përgatisin dhe kualifikojnë specialistë për ushtrimin e përgjegjësive dhe kompetencave.<br><br>*Evidenca nr.13 – "Informacion mbi programin e studimit"* |
| **Kriteri 4.** Programet e studimeve përafrohen me programe studimi të ngjashme të ofruar nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar. | Ky program studimi është çelur në kuadër të një konsorciumi rajonal të mbështetur nga Fondi i Hapur Rajonal GTZ për Europën Juglindore, me lektorë vendas e të huaj. Aktualisht struktura akademike bashkëpunuese për këtë program studimi janë Departamenti i të Drejtës Civile, Penale dhe Publike, FD, UT<br><br>*Evidenca nr. 8 – Memorandum mirëkuptimi për krijimin dhe zhvillimin e studimeve pasuniversitare për të Drejtësn e BE-së (dokument shqip)*<br><br>*Evidenca nr. 8.1 – The regional Master Programme on EU business Law – cooperation agreement for the organization and delivery of regional Master Programme on EU Business Law (dok anglisht)* |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 5.** Programet e studimit hartohen në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara mbështeten në përvojën disavjeçare të institucionit dhe praktikat e mira të vendeve evropiane. | Programi i studimit si një program rajonal mbështetet në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara. |
| **Kriteri 6.** Programet e ciklit të dytë "Master profesional" përfshijnë aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara. | Ky program studimi nuk përfshin praktikën profesionale. |
| **Kriteri 7.** Në varësi të profilit të institucionit, në programet e ciklit të dytë "Master profesional" mund të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj dhe ndërkombëtarizimin. | Në takimin me dekanin e FD, GVJ mësoi që ky program u krijua si pjesë e një masteri rajonal me lektorë vendas e të huaj dhe një pjesë e lëndëve u ofrua në gjuhën angleze në vitet e para të tij. Aktualisht ky program studimi ofrohet në gjuhën Shqipe.<br>*Evidenca nr.13 – "Informacion mbi programin e studimit"* |
| **Kriteri 8.** Programet e ciklit të dytë "Master profesional" mund të hapen përkohësisht në funksion të plotësimit të nevojave për personel të kualifikuar në një drejtim të caktuar. | Ky program studimi nuk e përmbush këtë nevojë. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [redacted] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi I.4**<br><br>**Programet e ciklit të dytë "Master profesional" janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni demonstron se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë. | Universiteti i Tiranës, si institucioni që ofron programin e studimit, është institucion publik i arsimit të lartë, në përbërje të të cilit janë 8 Fakultete (Njësi kryesore) dhe rreth 41 Departamente (Njësi bazë). Ai funksionon në përputhje me legjislacionin për arsimin e lartë. Fakulteti i Drejtësisë, si njësia kryesore pranë të cilit ofrohet programi i studimit "Master Profesional European Business Law", ka përvojë akademike shumë vjecare në fushën e studimeve juridike, në të cilën ofrohet dhe ky program studimi. Fakulteti i Drejtësisë ofron programe studime në të tre ciklet e studimit dhe ka kapacitetin e duhur akademik dhe shkencor për të gjitha këto programe studimi. Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi përbëhet nga personel akademik i kategorisë "Profesor" si dhe "Lektor" i punësuar me kohë të plotë ose të pjesshme. Për lëndë specifike, këto kategori personeli kombinohen me specialistë me përvojë profesionale në fushën e të drejtës së BE-së<br><br>Referuar dokumentit (*Evidenca nr. 14 – Personeli akademik i angazhuar në programin Master Profesional EU Business Laë"),* rezulton se Fakulteti i Drejtësisë për vitin akademik 2022 -2023 është i përberë nga Personeli Akademik Efektiv (PAE) në nivel fakulteti (**80 pedagogë PAE**) të cilët kanë kualifikimin si më poshtë:<br><br>**Kualifikimi** — **Nr. personel PAE**<br>Prof. Dr. — 14<br>Prof. Asoc. — 20<br>Dr./PhD — 32<br>Msc. — 14<br>**Gjithsej** — **80** |
| **Kriteri 2.** Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit | Fakulteti i Drejtësisë (si njësia kryesore) dhe Departamentet e të Drejtës Civile, Penale dhe Publike (si njësitë bazë përgjegjëse), pranë të cilëve ofrohet programi i studimit "Master Profesional European Business Law", zhvillojnë veprimtarinë e tyre akademike dhe shkencore në përputhje me fushën studimore të këtij programi studimi.<br><br>*Evidencë nr. 15.2 "Model Suplementi e Diplome".* |

| | |
|---|---|
| të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. | |
| **Kriteri 3**. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje. | Programi i studimit MP në "European Business Law" ofron njohuri të thelluara teorike në fushën e të drejtës së Biznesit të BE-së. Programi i studimit në të drejtën e BE-së është një program ndërdisiplinor (bazuar dhe në strategjinë e zhvillimit të UT-së, *(fq. 7)* dhe përputhet me fushën e përgjithshme dhe specifike të fushave të studimeve që ofrohen nga Departamenti i të Drejtës Civile, Penale & Publike (si njësitë bazë përgjegjëse për këtë program studimi).<br>*Evidenca nr. 1 "Rregullorja e programit të studimit "Master Profesional European Business Law".*<br>*Evidenca nr. 2 "Statuti i Universitetit të Tiranës";* |
| **Kriteri 4.** Në rastet kur institucioni ofron program të ciklit të dytë "Master profesional" në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere. | Ky program studimi është në përputhje me profilin e institucionit. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi I.5** | |
|---|---|
| **Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.** | |
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe | Universiteti i Tiranës ka përcaktuar në organigramën e vet njësitë përbërse të tij ku bëjnë pjesë 8 njësi kryesore |

| | |
|---|---|
| mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre. | (fakultete) dhe rreth 41 njësi bazë (departamente). Marrëdhëniet midis tyre janë përcaktuar në aktet e brendshme rregullatore të institucionit (statut, rregullore) si në nivel institucioni ashtu edhe në nivel njësish dhe zyraṣh. Në shqyrtim të këtyre dokumenteve si dhe takimeve të organizuara, GVJ vlerson se marrëdhëniet brenda institucionit janë bashkëpunuese me detyra të përcaktuara dhe me të drejta e përgjegjësi të njohura e të realizuara.<br><br>FDUT, si njësia kryesore për organizimin dhe funksionim e programit të studimit "Master Profesional European Business Law", koordinon punën ndërmjet njësive bazë dhe strukturave të tjera ndihmës akademike, për realizimin e procesit mësimor dhe shkencor.<br><br>*Evidenca nr. 1 "Rregullorja e programit të studimit "Master Profesional European Business Law".* |
| **Kriteri 2.** Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj. | Fakulteti i Drejtësisë, si njësia kryesore për programin e studimit "Master Profesional European Business Law" u krijua bazuar në marrëveshjen e bashkëpunimti të një konsorciumi rajonal të mbështetur nga Fondacioni Gjerman, GTZ. Aktualisht Fakulteti shfrytëzon marrëveshjet e bashkëpunimit që ka lidhur me organizma të ndryshëm edhe për realizimin e këtij masteri.<br><br>*Evidenca nr. 20 "Tabela e Marrëveshjeve të bashkëpunimit të Fakultetit të Drejtësisë me institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare gjatë vitit akademik 2020-2021 & 2021-2022"* |
| **Kriteri 3.** Për realizmin e programeve të ciklit të dytë "Master profesional", institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute, kompani, të fushës përkatëse, për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj. | Programi i studimit "Master Profesional European Business Law" nuk përfshin praktikë profesionale.<br><br>*Evidenca nr.1 "Rregullorja e programit të studimit "Master Profesional European Business Law".*<br>*Evidenca nr. 13 "Informacion mbi programin e studimit"* |
| **Kriteri 4.** Institucioni i arsimi të lartë vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e | Programi i studimit "Master Profesional European Business Law" nuk përfshin praktikë profesionale. |

| | |
|---|---|
| praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimit që ofron. | |
| **Kriteri 5.** Institucioni i arsimi të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit. | UT dëshmon që ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit. Në institucion funksionon tashmë Zyra e Karrierës e cila i trajnon studentët si të aplikojnë për punë, si të shkruajnë një CV apo letër motivimi. Organizohet dhe "Java e Karrierës" një aktivitet, siç u pohua dhe nga studentët, mjaft i dobishëm për ta. |
| **Kriteri 6.** Në mënyrë periodike njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve. | Ky program studimi mund të shfrytëzoj të gjitha marrëveshjet e bashkëpunimit që ka lidhur njësia kryesore me aktor të tjerë por nga dokumentacioni i dorëzuar nga GVB si dhe gjatë intersvistave të zhvilluara në IAL.<br><br>*Nuk rezulton një raport analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit (ky fakt është cituar dhe në RVB kriteri 4, fq. 5).*<br><br>*Evidenca nr. 20 Tabela e Marrëveshjeve të bashkëpunimit të Fakultetit të Drejtësisë me institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare gjatë vitit akademik 2020-2021 dhe 2021-2022* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [redacted] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I** | [redacted] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER PROFESIONAL

| **Standardi II.1** **Programet e studimit organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1** Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). | GVJ konstaton se programi i ciklit të dytë Master Profesional në "European Business Law" është i organizuar në lëndë të vlerësuara në kredite në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Programi i studimit ka një kohëzgjatje normale 1 vjecare dhe në total 60 kredite. Detyrimi përmbyllës për marrjen e diplomës shlyhet në trajtën e mbrojtjes së diplomës me temë.<br><br>*VKM nr. 41, datë 24.1.2018 i ndryshuar, VKM Nr. 879, date 18.12.2019, Evidenca nr. 1 "Rregullorja e Programit të Studimit Master Profesional European Business Law";*<br><br>*Evidenca nr. 13 "Informacion mbi programin e studimit"; Evidenca nr. 13, Pika 5 - Tabela e planit mësimor "Informacion mbi programin e studimit".* |
| **Kriteri 2** Programet e studimit të ciklit të dytë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionesh e specialitetesh. | GVJ konstaton se programi i studimit ciklit të dytë Master Profesional "European Business Law" nëpërmjet lëndëve të ofruara krijon mundësinë e formimit të shprehive të vecanta e të thellojnë njohuritë në të drejtën e biznesit të BE-së, si dhe të zhvillojnë më shumë aftësitë kërkimore, përfshirë edhe aftësinë për të transferuar njohuritë e përfituara në praktikë.<br><br>Ky program synon të plotësojë njohuritë dhe kompetencat e studentëve dhe profesionistëve nga këndvështrimi i BE-së si dhe mundëson zgjerimin e dijeve në fushën e legjislacionit tregtar, vendas dhe evropian, duke i mëshuar aspekteve teorike të mësimnxënies në këtë fushë.<br><br>*Evidenca nr. 1 "Rregullorja e Programit të Studimit Master Profesional European Business Law",*<br><br>*Evidenca nr. 13, "Informacion mbi programin e studimit";*<br><br>*Evidenca nr. 28 "Dosja e plotë didaktike"* |
| **Kriteri 3** Programet e studimit të ciklit të dytë japin njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku | Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe intervistave gjatë vizitës në institucion GVJ konstaton se programi Master Profesional "European Business Law", thellon njohuritë e studentëve në fushën e legjislacionit tregtar vendas dhe evropian, ku një vend |

| | |
|---|---|
| përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës. | të rëndësishëm zë të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës së "European Business Law"<br>*Evidenca nr. 1 "Rregullorja e Programit të Studimit Master Profesional European Business Law"; Evidenca nr. 13, "Informacion mbi programin e studimit".*<br>*Evidenca nr. 28 "Dosja e plotë didaktike".* |
| **Kriteri 4** Programet e studimit të ciklit të dytë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale. | Ndër objektivat formuese të programit të cikit të dytë të studimit Master Profesional "European Business Law" është tu japë studentëve njohuritë më bashkëkohore të nevojshme në fushën e të drejtës tregtare, mbështetur në këndvështrimin kërkimor-shkencor. Ndër të tjera programi synon që studentët të jnë të aftë të bëjnë interpretime të rasteve praktike duke u ndalur tek praktika gjyqësore europiane, si dhe analizimin e akteve më të rëndësishme të BE-së, direktivave në fushën e mbrojtjes së të drejtës së konsumatorit, konkurencës, pronësisë intelektuale, etj. GVJ konstaton se objektivat formuese përmbushen mjaft mirë dhe kjo rezulton e shprehur qartë në:<br>*Evidenca nr. 1 "Rregullorja e Programit të Studimit Master Profesional European Business Law",*<br>*Evidenca nr. 13, "Informacion mbi programin e studimit";*<br>*Evidenca nr. 28 "Dosja e plotë didaktike".* |
| **Kriteri 5** Programet e studimit të ciklit të dytë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore. | GVJ konstaton se programi i studimit Master Profesional European Business Law përmban të shprehura në mënyrë eksplicite shpërndarjen e krediteve midis lëndëve ***por jo kategorizimin e tyre në përputhje me aktet nënligjore në fuqi.***<br>Për të gjitha lëndët/modulet janë dhënë ngarkesa në kredit, format e ndryshme të mësimdhënies, orët mësimore në auditor dhe ngarkesa jashtë auditorit, por kategorizimi nuk i përgjigjet VKM nr. 41, datë 24.1.2018 i ndryshuar me VKM Nr. 879, date 18.12.2019.<br>*Evidenca nr. 1 "Rregullorja e Programit të Studimit Master Profesional European Business Law";*<br>*VKM nr. 41, datë 24.1.2018 i ndryshuar me VKM Nr. 879, date 18.12.2019.*<br>*Evidenca nr. 13, "Informacion mbi programin e studimit";*<br>*Evidenca nr. 28 "Dosja e plotë didaktike".* |
| **Kriteri 6** Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, | Nga shqyrtimi i programit mësimor dhe syllabuseve rezulton se ky program studimi ka të përcakuar ngarkesën në kredite të lëndëve ***por ndarja sipas veprimtarive formuese nuk është në përputhje me VKM Nr. 879, date 18.12.2019 nga A-E por A-*** |

| | |
|---|---|
| duke grupuar lëndët/modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite. | ***F. GVJ e gjykon këtë si një dobësi të Institucionit dhe rekomandon adresimin sa më të shpejtë nga Institucioni.***<br><br>*Evidenca nr. 1 "Rregullorja e Programit të Studimit Master Profesional European Business Law";*<br><br>*Evidenca nr. 13, "Informacion mbi programin e studimit";*<br><br>*VKM nr. 41, datë 24.1.2018 i ndryshuar me VKM Nr. 879, date 18.12.2019.*<br><br>*Evidenca nr. 13, "Informacion mbi programin e studimit";*<br><br>*Evidenca nr. 28 "Dosja e plotë didaktike";*<br><br>*Vizita në institucion 30-31 janar 2023.* |
| **Kriteri 7** Programet e studimit parashikojnë ngarkesën në kredite të dedikuara për praktikën profesionale, laboratorike e klinike me ekuivalentim sipas përcaktimeve në aktet nënligjore kombëtare dhe në përputhje me direktivat evropiane. | Nga shqyrtimi i programit mësimor GVJ konstaton se punimi i diplomës në programin e studimit ka 15 kredite, ***përkatësisht 25% të totalit të krediteve duke mos qenë në përputhje me VKM Nr. 879, date 18.12.2019, i cili detyrimet përmbyllëse në programet e studimit master profesional i ka përcaktuar në masën 10-20%.***<br><br>Fakulteti i Drejtësisë ka hartuar një udhëzues mbi strukturën dhe rregullat e shkrimit të tezës së masterit. Aktivitetet në kuadër të diplomës përfshijnë takime me pedagogun, përgatitjen dhe monitorimin e procesit të hartimit dhe shkruarjes së diplomës sipas udhëzuesit.<br><br>*Evidenca nr. 1 Rregullorja e Programit të Studimit "Master Profesional European Business Law";*<br><br>*Evidenca nr. 21 Udhëzues "Mbi strukturën dhe rregullat e shkrimit të tezës së masterit; Evidenca nr. 18 "Mbi ngritjen e komisioneve ad hoc nga Departamentet përgjegjëse"* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

| **Standardi II.2** | |
|---|---|
| **Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.** | |
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse | Fakulteti i Drejtësisë, si njësia kryesore pranë të cilit ofrohet programi i studimit "Master Profesional European Business |

<table>
<tr>
<td>për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</td>
<td>Law", ka përvojë akademike shumë vjecare në fushën e studimeve juridike, në të cilën ofrohet dhe ky program studimi. Fakulteti i Drejtësisë ofron programe studime në të tre ciklet e studimit dhe ka kapacitetin e duhur akademik dhe shkencor për të gjitha këto programe studimi. Institucioni ka zhvilluar procesin e vlerësimit institucional në kuadër të akreditimit periodik. Ky vlerësim u finalizua me Vendimin e Bordit të Akreditimit Nr. 4 datë 27.01.2023, që e akrediton institucionin për 6 vite akademike.<br><br>Evidenca nr. 2 "Statuti i Universitetit të Tiranës";</td>
</tr>
<tr>
<td>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</td>
<td>FDUT është njësi kryesore e Universitetit të Tiranës dhe ofron programe studimi në të tre ciklet e studimit. FDUT është organizuar në tri njësi bazë/departamente:<br>- Departamenti i së Drejtës Civile;<br>- Departamenti i së Drejtës Penale;<br>- Departamenti i së Drejtës Publike;<br><br>Programi i Studimit "Master Profesional European Business Law" organizohet nga të tre departamentet.<br><br>Evidenca nr. 2 "Statuti i Universitetit të Tiranës";<br><br>Evidenca nr.14.2 "Organigrama e FDUT për vitin akademik 2021-2022".</td>
</tr>
<tr>
<td>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.</td>
<td>Duke analizuar të dhënat në dosjen DVV rezulton se çdo njësi bazë e FD plotëson kriterin ligjor për sa i përket numrit dhe kualifikimit shkencor. Të tre Departamentet si njësi përgjegjëse për programin e stuidimit referuar dokumentit (Evidenca nr. 14 – Personeli akademik i angazhuar në programin Master Profesional EU Business Laë"), në vitin akademik 2022-2023 kanë këtë paraqitje:
<table>
<tr><th rowspan="2">Kualifikimi</th><th>Departamenti i së Drejtës Penale</th></tr>
<tr><th>PAE</th></tr>
<tr><td>Prof. Dr.</td><td>4</td></tr>
<tr><td>Prof. Asoc.</td><td>10</td></tr>
<tr><td>Dr./PhD</td><td>9</td></tr>
<tr><td>Msc.</td><td>4</td></tr>
<tr><td>Gjithsej</td><td>27</td></tr>
</table>
<table>
<tr><th rowspan="2">Kualifikimi</th><th>Departamenti i së Drejtës Civile</th></tr>
<tr><th>PAE</th></tr>
<tr><td>Prof. Dr.</td><td>6</td></tr>
<tr><td>Prof. Asoc.</td><td>7</td></tr>
</table>
</td>
</tr>
</table>

| | |
|---|---|
| Dr./PhD | 9 |
| Msc. | 7 |
| **Gjithsej** | **29** |

| **Kualifikimi** | **Departamenti i së Drejtës Publike** |
|---|---|
| | **PAE** |
| Prof. Dr. | 4 |
| Prof. Asoc. | 3 |
| Dr./PhD | 14 |
| Msc. | 3 |
| **Gjithsej** | **24** |

Për sa më sipër GVJ konstaton se njësia kryesore dhe të tre njësitë bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbushin detyrimet ligjore dhe nënligjore për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.

*Evidenca nr. 14 – Personeli akademik i angazhuar në programin Master Profesional EU Business Law" ;*

*Evidenca nr. 14.1 – Organika analitike e personelit akademik të Fakultetit të Drejtësisë, UT 2022;*

*2022;Evidenca nr.14.2 "Organigrama e FDUT për vitin akademik 2021-2022".*

| | |
|---|---|
| **Kriteri 4.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike. | Programi i studimit Master Profesional "European Business Law", është krijuar me VKM nr. 802, datë 22.7.2009 i ndryshuar me VKM 1051, dt. 23.10.2009 dhe ofrohet nga Fakultetin e Drejtësisë si bashkëpunim ndërmjet tre njësive bazë të këtij fakulteti (Departamenti i të Drejtës Civile, Penale dhe Publike). GVJ nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatoi se ky master u krijua si pjesë e një masteri rajonal me lektorë vendas e të huaj dhe një pjesë e lëndëve u ofrua në gjuhën angleze. Aktualisht struktura akademike bashkëpunuese për këtë program studimi janë Departamenti i të Drejtës Civile, Penale dhe Publike, FD, UT.<br>*Evidenca nr. 10 "Rregullorja e Brendshme për organizimin e programit rajonal të masterit për të drejtën e biznesit të BE-së";*<br>*Evidenca nr. 1 "Rregullore Programi i Studimit të Masterit Profesional "European Business Law";*<br>*Evidenca nr.7 "VKM-të Për hapjen e Masterit ;*<br>*Evidenca nr.14.1 "Mbi strukturën akademike në programin e studimit Master Profesional "European Business Law".* |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 5.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike. | GVJ konstaton se FDUT ka në strukturën e tij personel ndihmës akademik 19 persona. Ata janë të përfshirë kryesisht në mbështetje dhe ndihmë të mbarëvajtjes së procesit mësimor (kujdesin për sallat, pajisjet, dokumentacionin, etj.). Personeli ndihmës akademik përbëhet nga staf me kohë të plotë, në ndihmë të realizimit të orëve mësimore, projekteve studimore e kërkimore etj. Sipas Statutit të UT-së, personeli ndihmës akademik ndahet në personel ndihmës akademik me karakter mësimor shkencor dhe ndihmës akademik me karakter administrativ. Personeli ndihmës akademik me karakter mësimor-shkencor ndihmon në realizimin dhe mbështetjen e veprimtarive të mësimdhënies dhe/ose të kërkimit shkencor. Ai është pjesë e njësisë bazë dhe shërben për mbështetjen e veprimtarive të kësaj të fundit. Personeli ndihmës akademik me karakter administrativ ndihmon në realizimin dhe mbështetjen e veprimtarive të mësimdhënies dhe/ose të kërkimit shkencor dhe/ose të zhvillimit të institucionit të arsimit të lartë në nivel njësie bazë, njësie kryesore ose në nivel institucional.<br><br>*Evidenca nr.2, "Statuti i Universitetit të Tiranës";*<br><br>*Evidenca nr. 14.2, "Organigrama e FDUT për vitin akademik 2021-2022";*<br><br>*Evidenca nr. 22, "Mbi Rregulloren e Bibliotekës";*<br><br>*Evidenca nr. 13 , "Informacion mbi programin e studimit* |
| **Kriteri 6.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. | Na takimi i zhvilluar në institucion GVJ konstatoi se përgjegjësia për ecurinë dhe zhvillimin e programit të studimit në përputhje me objektivat e tij është e Dr. J. B., personel akademik me kohë të plotë pranë Departamentit të së Drejtës Penale<br><br>*Vizita në institucion: Shënime në vizitë_ 30-31 Jananr 2023* |
| **Kriteri 7.** Koordinatori i programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësisë përgjegjëse dhe | GVJ konsultoi dokumentacionin që lidhet me ecurinë e programit të studimit, dhe konstatoi që koordinatori i programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i departamentit dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit. | *Vizita në institucion* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [redacted] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi II.3**<br><br>**Programet e studimit të ciklit të dytë janë të detajuara, informuese, të strukturuara dhe të organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të dytë.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve. | GVJ konstaton se Departamentet e të Drejtës Civile, Publike dhe Penale disponojnë dhe kanë vënë në dispozicion të gjitha informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit: Rregulloren, planin mësimor, dosjen e plotë didaktike etj.<br><br>*Evidenca nr. 1 "Rregullorja e Programit të Studimit Master Profesional European Business Law";*<br><br>*Evidenca nr. 13 "Informacion mbi programin e studimit";*<br><br>*Evidenca nr. 14 – Personeli akademik i angazhuar në programin Master Profesional EU Business Law" ;*<br><br>*Evidenca nr. 28 "Dosja e plotë didaktike".* |
| **Kriteri 2.** Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. | GVJ konstaton se veprimtaritë formuese nuk janë shpërndarë në përputhje me VKM 41. Nga shqyrtimi i rregullores së programit, planit mësimor dhe syllabuseve, GVJ konstaton se programi përmban: 9 lëndë, nuk përmban praktikë profesionale dhe punimi i diplomës.<br><br>Në syllabuse paraqitet qartë ndarja e elementëve të lëndës (leksion, seminar) por syllabuset duhet të standardizohen sipas aktivitetit formues në lëndë, praktikë profesionale dhe punim diplome sipas përqindjeve(%) të përcaktuara në VKM 879 datë 18.12.2019.<br><br>*Evidenca nr. 13 "Informacion mbi programin e studimit";*<br><br>*Evidenca nr. 12.1 "Plani Mësimor i Studimit "Master Profesional European Business Law"*<br><br>*Evidenca nr. 28 "Dosja e plotë didaktike".* |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 3.** Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra. | Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton shpërndarja e krediteve në dy semestra. Programi i studimit Master Profesional "European Business Law" rezulton me 30 kredite për semestër, 60 kredite dhe kohëzgjatje 1 vit akademik.<br><br>*Evidenca nr. 12.1 "Plani Mësimor i Studimit "Master Profesional European Business Law"*<br><br>*Evidenca nr. 13 "Informacion mbi programin e studimit"* |
| **Kriteri 4.** Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj. | GVJ konstaton se plani mësimor përmban informacionet për ngarkesën mësimore, orët në auditor dhe jashtë auditorit. Frekuentimi i programit të studimit dhe mënyra e vlerësimit të dijeve caktohen në rregulloren e programit dhe në syllabuse. Në syllabuset e lëndëve jepet informacion në lidhje me temat mësimore në leksione dhe në seminare detyrimet lidhur me lëndët etj.<br><br>*Evidenca nr. 12.1 "Plani Mësimor i Studimit "Master Profesional European Business Law"*<br><br>*Evidenca nr. 13 "Informacion mbi programin e studimit";*<br><br>*Evidenca nr. 28 "Dosja e plotë didaktike".* |
| **Kriteri 5.** Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. | Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se Rregullorja e programit të studimit Master Profesional "European Business Law" përmban të gjitha informacionet e nevojshme që lidhen me kriteret e pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.<br><br>*Evidenca nr. 1 "Rregullorja e Programit të Studimit Master Profesional European Business Law"* |
| **Kriteri 6.** Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminaret apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara. | Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se syllabuset e lëndëve nuk janë të paraqitura në strukturë në përputhje me aktet nënligjore në fuqi.<br><br>*Evidenca nr. 28 "Dosja e plotë didaktike".*<br><br>*VKM nr. 41, datë 24.1.2018 i ndryshuar,*<br><br>*VKM Nr. 879, date 18.12.2019* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Kriteri 7.** Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë. | GVJ konstaton se personeli akademik përditëson syllabuset në fillim të vitit akademik si përgjigje ndaj ndryshimeve ligjore por edhe dinamikave të tregut të punës.<br><br>*Evidenca nr. 28 "Dosja e plotë didaktike".* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | **X** | |

| **Standardi II.4**<br><br>**Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi. | GVJ konstaton se programi i studimit Master Profesional "European Business Law" është i organizuar në 1 vit akademik, me 60 kredite në total. Konstatohet se programi i studimit është i strukturuar si më poshtë:<br><br>(shih tabelën më poshtë)<br><br>*Evidenca nr. 12.1 "Plani Mësimor i Studimit "Master Profesional European Business Law"* |
| **Kriteri 2.** Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë thellim të njohurive dhe aftësive dhe/ose punësimin e studentëve. | GVJ konstaton se emërtimi i programit të studimit Master Profesional "European Business Law" është në përputhje me fushën akademike të tij. Përmbajtja e veprimtarive mundëson përgatitjen e studentëve me aftësi teorike dhe praktike. Plani mësimor, natyra dhe emërtimi i moduleve/lëndëve janë hartuar duke mbajtur parasysh informimin sa më të mirë të studentit, pasi përmbajnë të gjitha elementët e kërkuara të përfshira në syllabuset e lëndëve/moduleve e të aktiviteteve |

| Viti akadmik | Ngarkea e lëndëve | | Total orë/ 60 ECTS |
|---|---|---|---|
| | Auditor | Jashtë auditorit | |
| Viti I | 570 orë | 930 orë | 1500 orë |

| | |
|---|---|
| | formuese. Në lidhje me sa më lart GVJ vlerëson se ky program studimi mundëson përgatitjen e studentëve me aftësi teorike dhe praktike nëpërmjet rasteve studimore, një elemnt mjaft i rëndësishëm ky për t'u përballur me tregun e punës.<br><br>*Evidenca nr. 1 "Rregullorja e Programit të Studimit Master Profesional European Business Law";*<br><br>*Evidenca nr. 28 "Dosja e plotë didaktike ;*<br><br>*Evidenca nr. 7 – Vendim i Keshillit të Ministrave nr.802, datë 22.07.2009 : Për hapjen e Programit të Përbashkët Rajonal të Studimit Master në "EU Business Law", në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës;* |
| **Kriteri 3.** Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimit profesional. | Lëndët e PS Master Profesional "European Business Law"" janë të shpërndara në semestra (gjithsej 2) dhe në vite akademike (1).<br><br>Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se lëndët janë në përputhje me profilin e programit të studimit Master Profesional "European Business Law" dhe rezultateve të pritshme të të nxënit, aftësimit profesional dhe kërkimit shkencor.<br><br>*Evidenca nr. 1 "Rregullorja e Programit të Studimit Master Profesional European Business Law";*<br><br>*Evidenca nr. 28 "Dosja e plotë didaktike*<br><br>*Vizita në institucion: Shënime në vizitë_ 30-31 Janar 2023* |
| **Kriteri 4.** Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teoripraktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. | Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në institucion, GVJ konstaton se mundësohet arritja e objektivave formues të programit të studimit Master Profesional "European Business Law" dhe rrjedhimisht të domosdoshme për formimin e specialistëve në këtë fushë studimi. Nga vizita në institucion, takimi me studentët dhe stafin akademik, GVJ konstaton se raporti njohuri teorike dhe njohuri praktike është në përputhje me profilin e programit master. Lëndët janë të organizuara në Leksione dhe seminare.<br><br>*GVJ rekomandon të bëhet një shpërndarje më e mirë në plan, të % midis njohurive teorike dhe praktike duke i dhënë më shumë peshë orëve të seminareve në përputhje me ciklin e dytë të studimeve.*<br><br>*Evidenca nr. 28 "Dosja e plotë didaktike" ;* |

| | |
|---|---|
| | *Evidenca nr. 1 "Rregullorja e Programit të Studimit Master Profesional European Business Law";*<br><br>*Evidenca nr. 13, Pika 5 - Tabela e planit mësimor "Informacion mbi programin e studimit".* |
| **Kriteri 5.** Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve. | Gjatë intervistave me personelin akademik dhe me studentët evidentohet arritja e objektivave formues dhe formimin e specialistëve të aftë në fushën e të drejtës tregtare europiane.<br><br>*Evidenca nr. 1 "Rregullorja e Programit të Studimit Master Profesional European Business Law";* |
| **Kriteri 6.** Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit. | Nga takimet në institucion me personelin akademik si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, GVJ konkludon se ndryshimet në programet e lëndëve janë të vogla. Pjesëmarrja në projektet e programit ERASMUS+, ku synohet dhe modernizimi i procesit mësimor, mundëson përditësimin në mënyrë të vazhdueshme të syllabuseve, duke u bazuar dhe në literaturë të detyruar e ndihmëse të 5 viteve të fundit. GVJ konstaton se personeli akademik përditëson syllabuset në fillim të vitit akademik si përgjigje ndaj ndryshimeve ligjore por edhe dinamikave të tregut të punës.<br><br>*Evidenca nr. 28 "Dosja e plotë didaktike".* |
| **Kriteri 7.** Përmbajtja e programeve të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të dytë. | GVJ bazuar në lëndët e programit të studimit dhe syllabuse, konstaton se programi i studimit Master Profesional "European Business Law" ka përmbajtje didaktike dhe profesionale formuese dhe garanton përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave që synon programi dhe niveli master. Disa nga lëndët që përfshihen në këtë program studimi garantojnë përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave që synon programi, konkretisht:<br><br>E drejta e Konkurrencës në BE;<br><br>E Drejta e Konsumatorit në BE;<br><br>E Drejta e Tregut të Brendshëm etj;<br><br>*Evidenca nr. 28 "Dosja e plotë didaktike" ;*<br><br>*Evidenca nr. 1 "Rregullorja e Programit të Studimit Master Profesional European Business Law";*<br><br>*Evidenca nr. 13, Pika 5 - Tabela e planit mësimor "Informacion mbi programin e studimit".* |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 8.** Organizimi i programit të studimit siguron aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional. | Programi i studimit Master Profesional "European Business Law" u jep mundësi studentëve të pozicionohen qartësisht në karrierën e tyre të ardhshme profesionale. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, vizita në institucion dhe intervistimi i studentëve, GVJ konstaton se, programi i studimit siguron aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional Në European Bussiness Law.<br>*Evidenca nr. 28 "Dosja e plotë didaktike" ;*<br>*Evidenca nr. 1 "Rregullorja e Programit të Studimit Master Profesional European Business Law";* |
| **Kriteri 9.** Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës. | GVJ konstaton se njohuritë e fituara gjatë programit të studimit Master Profesional "European Business Law" i pajisin studentët me formimin e nevojshëm për të ndjekur studimet e ciklit të tretë. Studentët inkurajohen nga institucioni të marrin pjesë në konferenca dhe aktivitete shkencore në funksion të kërkesave të tregut të punës.<br>*Evidenca nr 27 "Informacion i detajuar mbi takimet dhe aktivitetet e zhvilluara nga Fakulteti i Drejtësisë"*<br>*Evidenca nr. 28 "Dosja e plotë didaktike" ;*<br>*Evidenca nr. 1 "Rregullorja e Programit të Studimit Master Profesional European Business Law";* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi II.5** | |
|---|---|
| **Personeli akademik dhe ndihmës-akademik, që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik dhe profesional për garantimin e standardeve të mësimdhënies në kuadër të programit të studimit.** | |
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |





**Kriteri 1.** Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.

**Kriteri 2.** Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.

Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se personeli akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme i angazhuar në realizimin e programit të studimit bazuar në *tabelat 6.1 – 6.3 të Dokumentacion shtesë për programin e studimit MP \"EU Business Law\", Aneks, Tabelat përmbledhëse*, është:

1. Për vitin akademik 2021- 2022 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 12 pedagogë të gjithë PAE (100 %);
2. Për vitin akademik 2020- 2021 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 13 pedagogë të gjithë PAE (100 %);
3. Për vitin akademik 2019 - 2020 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 13 pedagogë nga të cilët 12 PAE dhe 1 PAK (95 % / 15 %);

| Tituj/grada | **2021 - 2022** | | **2020- 2021** | | **2019 - 2020** | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | PAE | PAK | PAE: | PAK: | PAE: | PAK: |
| Prof.Dr | 7 | - | 7 | - | 7 | - |
| Prof.As.Dr | 2 | - | 3 | - | 3 | - |
| Dr/PhD | 3 | - | 3 | - | 2 | - |
| Msc | - | - | - | - | - | 1 |
| Në total | **12** | **0** | **13** | **0** | **12** | **1** |

*Dokumentacion shtesë për programin e studimit MP \"EU Business Law\", Aneks, Tabelat përmbledhëse*

Nga verifikimi i personelit akademik i përfshirë në mësimdhënie, GVJ konstaton qëndrueshmëri të stafit akademik.

GVJ pasi analizoi informacionin e dhënë në tabelat 12.1-12.3 *të Dokumentacion shtesë për programin e studimit MP \"EU Business Law\", Aneks, Tabelat përmbledhëse*, për ngarkesën mësimore të personelit akademik PAE dhe PAK rezultoi se raporti i ngarkesës mësimore (orë mësimore) PAE/PAK është si më poshtë:

- 2019-2020 **96 % / 4%**
- 2020-2021 **100 %**
- 2021-2022 **100 %**

| | |
|---|---|
| | Kërkesa ligjore që stafi akademik PAE të mbulojë të paktën 70% të ngarkesës përmbushet plotësisht.<br><br>*Evidenca nr.13 Tabela 4 "Mbi personelin akademik të angazhuar në programin e studimit Master Profesional European Business Law"* |
| **Kriteri 3.** Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij. | Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se personeli akademik i programit ka njohuri në përputhje me natyrën e programit. Rezulton se personeli akademik i programit është i specializuar në fusha specifike të cilat mbulojnë të gjitha lëndët që zhvillohen në këtë program studimi, gjë që garanton formimin e specialistëve të fushës me aftësi të larta.<br><br>*Evidencë nr. 37 – CV-të e pedagogëve të angazhuar në mesimdhënie Master Profesional EU Business Law.* |
| **Kriteri 4.** Institucioni i arsimit të lartë, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për udhëzimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit. | Programi i studimit "Master Profesional European Business Law" nuk përfshin praktikë profesionale por vetëm temë diplome për të cilin angazhohen të gjithë pedagogët e këtij programi. (*Neni 8*)<br><br>*Evidenca nr. 1 "Rregullorja e Programit të Studimit Master Profesional European Business Law";*<br><br>*Evidenca nr.21 Udhëzues "Mbi strukturën dhe rregullat e shkrimit të tezës së masterit";*<br><br>*Evidenca nr. 13 Tabela 6 "Mbi planin mësimor të programit të studimit Master Profesional në "Të Drejtë Biznesi të BE-së"/EU Business Law";*<br><br>*Evidenca nr. 21 "Informacion mbi zhvillimin e temave";*<br><br>*Evidenca nr. 18"Mbi ngritjen e komisioneve ad hoc nga Departamentet përgjegjëse".* |
| **Kriteri 5.** Institucioni i arsimit të lartë siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësmësimor-shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për | Nuk aplikohet sepse nuk ka orë laboratorike. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit. | | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | X |

| **Standardi II.6**<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit dhe realizimin me sukses të tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës. | Nga vizita në institucion dhe dokumentacioni i shqyrtuar konstatohet se njohja me kërkesat e tregut të punës realizohet përmes marrëveshjeve të bashkëpunimit. Njësia e Kërkimit Shkencor, rishikon në mënyrë të vazhdueshme mundësinë për krijimin e marrëdhënieve afatgjata me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, me punëdhënës vendas ose të huaj, në mbështetje të programit dhe departamentet e FD, duke qënë përgjegjës për përmirësimin dhe zhvillimin e kurrikulës, bëjnë rekomandimet e veta me qëllim përshtatjen sa më të mirë të programit të studimit me kërkesat e tregut të punës.<br><br>*Evidenca nr. 7 – Vendim i Keshillit të Ministrave nr.802, datë 22.07.2009 : Për hapjen e Programit të Përbashkët Rajonal të Studimit Master në "EU Business Law", në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës ;*<br><br>*Evidenca nr. 13 "Informacion mbi programin e studimit"*<br><br>*Evidenca nr. 20 "Tabela e Marrëveshjeve të bashkëpunimit të Fakultetit të Drejtësisë me institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare gjatë vitit akademik 2020-2021 & 2021-2022"* |
| **Kriteri 2.** Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime, në kuadër të përmirësimit të programit të studimit, edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe | Nga intervistat me studentët dhe stafin akademik në kuadër të përmirësimit të programit të studimit FD inkurajon dhe përfshin në diskutime edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet dhe opinionet e tyre diskutohen në nivel Departamenti dhe Fakulteti dhe nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit gjejnë reflektim në |

| | |
|---|---|
| reflektohen nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit. | programet e studimit.<br><br>*Evidenca nr 27 "Informacion i detajuar mbi takimet dhe aktivitetet e zhvilluara nga Fakulteti i Drejtësisë".* |
| **Kriteri 3.** Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programeve të studimit. | Fakulteti i Drejtësisë inkurajon dhe përfshin në diskutime edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet dhe opinionet e tyre diskutohen në nivel Departamenti dhe Fakulteti dhe nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit gjejnë reflektim në programet e studimit.<br><br>*Evidenca nr 27 "Informacion i detajuar mbi takimet dhe aktivitetet e zhvilluara nga Fakulteti i Drejtësisë".* |
| **Kriteri 4.** Në bashkëpunim me institucionet publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme në përputhje me kërkesa dhe nevoja specifike lokale dhe zhvillimi. | GVJ konstaton se bashkëpunimet me institucione të ndryshme kërkimore e shkencore në fushën e teknologjisë së informacionit i japin mundësi Fakultetit të Drejtësisë të konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me ta për përmirësimin e programit Master Profesional European Business Law"<br><br>*Evidenca nr. 25 "Krijimi i Qendrës Virtuale të Trajnimit nëUT – Vendim i Senatit UT, nr.48";*<br><br>*Evidenca nr.25"Trajnimet e ofruara nga Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit në Universitetin e Tiranës";*<br><br>*Evidenca nr.27 "Informacion i detajuar mbi takimet dhe aktivitetet e zhvilluara nga Fakulteti i Drejtësisë".* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

## III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

| Standardi III.1<br>**Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve. | Pas shqyrtimit të dokumentacionit në dosjen DVV dhe vizitës në institucion, GVJ konstaton se Universiteti i Tiranës në nivel institucional ka hartuar udhëzuesin për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve moduleve. Programi i cikilit të dytë të studimit "Master Profesional" në "European Business Law" zhvillon programin mësimor të hartuar dhe miratuar në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe akteve të brendshme të institucionit. Me vendim nr. 24 datë 27.07.2022 është miratuar "Strategjia institucionale për mësimëdhënien në Universitetin e Tiranës 2022-2027" e cila paraqet një udhëzues në nivel institucioni të metodave të aplikimit të mësimëdhënies. Në bazë të rregullores së programit të studimit (*neni 3 dhe neni 6),* veprimtaria mësimore zhvillohet në në formën e leksioneve, seminareve, konferencave, mësimit interaktiv, projekteve/detyrave. Këto forma aplikohen nga stafi akademik në përputhje me syllabusin e lëndës.<br>*Evidenca nr. 1 "Rregullorja e Programit të Studimit "Master Profesional European Business Law"*<br>*Evidenca nr. 2 "Statuti i Universitetit të Tiranës"*<br>*Evidenca nr. 6 "Strategjia institucionale e mësimëdhënies Universiteti i Tiranës 2022-2027"*<br>*Evidenca nr. 28 "Dosja e plotë didaktike".* |
| **Kriteri 2.** Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit | Strukturat përgjegjëse të institucionit (drejtuesit e njësive bazë dhe drejtuesi i njësisë kryesore si dhe zyra e burimeve njerzore) vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimëdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik nëpërmjet mekanizmave të paracaktuara të monitorimit. Ky vlerësim zhvillohet të paktën 1 herë në vit dhe rezultati i tij bëhet pjesë e dosjes së personelit. |

| | |
|---|---|
| akademik dhe ndihmësakademik. | *Evidenca nr. 2 "Statuti i Universitetit të Tiranës"*<br><br>*Evidenca nr. 34 "Vendim Rektorati nr. 3 datë 24.01.2022 për miratimin në parim të Rregullores "Mbi vlerësimin e performancës në punë të personelit ndihëmës akademik dhe administrative të UT"*<br><br>*Evidenca nr. 38 Model kontrate pune për personelin akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme* |
| **Kriteri 3.** Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve. | Institucioni në mënyrë periodike harton pyetsor për vlerësimin nga ana e studentit të formave dhe metodave të mësimëdhënies. Në fillim të çdo semestri studentëve iu vihen në dispozicion syllabuset për çdo lëndë që ofrohet nga pedagogët përkatës. Këto programe depozitohen në Departamentet përkatëse si njësi bazë përgjegjëse në aspektin akademik dhe administrativ dhe mund të publikohen në formën e një broshure nga Fakulteti i Drejtësisë dhe/ose në faqen e internetit të Fakultetit të Drejtësisë. Format dhe kriteret e vlerësimit të studentit përcaktohen në programin e çdo lënde dhe i bëhen të ditura paraprakisht studentëve.<br><br>*Evidenca nr. 1 "Rregullorja e Programit të Studimit "Master Profesional European Business Law".*<br><br>*Evidenca nr. 39 – Model pyetësori studenti* |
| **Kriteri 4.** Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit. | Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë është struktura përgjegjëse për vlerësimin periodik të rezultateve të veprimtarive mësimore në Universitetin e Tiranës. NJBSC analizon, mbi bazën e metodave statistikore, vlerësimet e cilësisë së mësimdhënies dhe gjeneron një raport individual për secilin anëtar të stafit akademik. Raporti komunikohet tek autoritetet drejtuese të Universitetit të Tiranës.<br><br>*Evidenca 68 - Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT.pdf* |
| **Kriteri 5.** Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. | Institucioni garanton qëndrueshmërinë e stafit akademik në këtë program studimi, duke vlerësuar cilësinë dhe profesionalizmin e tyre në aspektin mësimdhënës.<br><br>Universiteti i Tiranës, bazuar në nenin 37, pika 1, të Ligjit nr. 80/2015 *"Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"*, neni 30 pika 1, të Statutit të UT-së; me vendimin e datës 25.11.2021, Senati Akademik i UT-së, ka miratuar ngritjen e Qendrës Virtuale të Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit në Universitetin e Tiranës. Përmes klësaj qendre ofrohen trjnime të vijueshme për personelin akademik. Shih: |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | https://unitir.edu.al/qender-virtuale-e-trajnimit-dhe-zhvillimit-profesional/<br><br>*Evidenca nr. 25 "Krijimi i Qendrës Virtuale të Trajnimit nëUT –Vendim i Senatit UT nr.48";*<br><br>*Evidenca nr. 25 "Trajnimet e ofruara nga Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit në Universitetin e Tiranë";*<br><br>*Evidenca nr. 27 "Informacion i detajuar mbi takimet dhe aktivitetet e zhvilluara nga Fakulteti i Drejtësisë".*<br><br>*Evidenca nr. 34 _Vendim Rektorati, nr.3, datë 24.01.2022 për miratimin në parim të Rregullores "Mbi vlerësimin e performancës në punë të personelit ndihmës akademik dhe administrative në UT"* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi III.2**<br><br>**Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë: leksionet, seminaret, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni. | Në bazë të rregullores së programit të studimit (*neni 3 dhe neni 6*), veprimtaria mësimore e Masterit Profesional "European Business Law" zhvillohet sipas programit mësimor në formën e leksioneve, seminareve, konferencave, mësimit interaktiv, projekteve/detyrave. Këto forma zhvillohen në përputhje me ngarkesën e parashikuar për çdo lëndë dhe sipas përmbajtjes të përcaktuar në syllabuset e lëndëve përkatësisht moduleve. Ato zhvillohen në auditore.<br><br>Gjatë vizitës në institucion, GVJ vizitoi ambjentet e vëna në dispozicion të mësimdhënjes dhe i gjeti ato funksionale për programin mësimor.<br><br>*Evidenca nr. 1 "Rregullorja e Programit të Studimit "Master Profesional European Business Law"*<br><br>*Evidenca nr. 28 "Dosja e plotë didaktike".* |
| **Kriteri 2.** Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'i përgjigjet | Programi i studimit "Master Profesional" në "European Business Law" rishikohet në mënyrë periodike, në lidhje me veprimtaritë formuese dhe metodat e mësimdhënies. Kërkesa |

| | |
|---|---|
| diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij. | për përmirësimin e këtyre komponentëve të programit të studimit bëhen nga stafi akademik i Fakultetit të cilët janë pjesë e këtij programi studimi. Rishikimi bëhet në përputhje me kërkesat e tregut të punës, dinamikave të brendshme dhe/ose si përgjigje ndaj kërkesave të akteve ligjore dhe nënligjore në fushën e arsimit të lartë. Propozimi për ndryshime në çdo rast vjen i argumentuar dhe shqyrtohet nga Departamentet përgjegjëse dhe nga Dekanati. (*Neni 47*)<br><br>*Evidenca nr. 1 "Rregullorja e Programit të Studimit "Master Profesional European Business Law"*<br><br>*Evidenca nr. 28 "Dosja e plotë didaktike"*<br><br>*Evidenaca nr. 37 – CV-të e pedagogëve të angazhuar në mësimëdhënie në programin "Master pofesional" në "Europena Business Law"* |
| **Kriteri 3.** Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni duhet të mundësojë përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. | GVJ konstaton se Universiteti i Tiranës angazhohet për përmirësimin e kompetencave didaktike të personelit të tij akademik. Ai ka hartuar një udhëzues për këtë qëllim dhe zhvillon trajnime me qëllim përmirësimin e kompetencave didaktike. GVJ gjatë vizitës në institucion konstaton se mjediset ku zhvillohet mësimi i programit të studimit "Master Profesional" në "European Business Law" mundësojnë për personelin akademik përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike.<br><br>*Evidenca 34 – Trajnime për stafin akademik mbi platformën Microsoft Teams;*<br><br>*Evidenca 54 – Komunikim në MS Teams ndërmjet një studenti dhe një pedagogu;*<br><br>*Evidenca nr. 25 "Krijimi i Qendrës Virtuale të Trajnimit nëUT – Vendim i Senatit UT nr.48";*<br><br>*Evidenca nr. 25 "Trajnimet e ofruara nga Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit në Universitetin e Tiranë";* |
| **Kriteri 4.** Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit. | Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi në pjesën më të madhe rezulton i angazhuar në procesin e mësimëdhënies që në fillimit e këtij programi studimi. Kjo cilësi paraqet një vlerë të shtuar për cilësinë e mësimëdhënies dhe qëndrueshmërisë së programit si dhe është një element i garantimit të cilësisë të mësimëdhënies. |

| | |
|---|---|
| | *Evidenca nr. 13 Tabela 4 "Mbi personelin akademik të angazhuar në programin e studimit "Master Profesional "European Business Law;* |
| **Kriteri 5.** Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre. | Format dhe metodat e mësimëdhënies janë të paracaktuara në syllabuset e lëndëvë të programit të studimit. Këto syllabuse përditësohen përpara çdo fillimi të vitit akademik nga pedagogu i lëndës dhe miratohen nga përgjegjësi i Departamentit. Literatura, përbajtja dhe metodologjia e mësimëdhënies janë objekt rishikimi të vazhdueshëm nga personeli akademik në përputhje me kërkesat kohës dhe zhvillimeve aktuale.<br><br>*Evidenca nr. 13 Tabela 5 "Mbi lëndët dhe pedagogët në programin e studimit "Master Profesional European Business Law";*<br><br>*Evidenca nr. 28 "Dosja e plotë didaktike".* |
| **Kriteri 6.** Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimit. | Nga takimi i zhvilluar me stafin akademik dhe studentët e programit të studimit si dhe hulumtimi i syllabusve të miratual rezulton që orët mësimore janë interaktive në trajtimin e kazuzve ndërkombëtar në varësi të natyrës së lëndës që zhvillohet. Trajtimi i rasteve praktike paraqet interes të veçantë jo vetëm në asimilimin e lëndës por edhe në zbatimin në praktik të teorisë së përvetësuar gjatë zhvillimit të orës.<br><br>*Evidenca nr. 28 "Dosja e plotë didaktike".* |
| **Kriteri 7.** Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë te studenti, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre. | Nga analizimi i dokumentacionit të programit të studimit dhe takimet fizike të zhvilluara me aktorët e intervistave të paracaktuara rezulton që <u>ky program studimi nuk ka të programuar orët e praktikës</u>. Këto orë rezultojnë të jenë pjesë integrale e lëndëve përkatëse të cilat trajtojnë raste praktike në auditor duke angazhuar studentët të kene rol aktiv në procesin e zgjidhjes së situatave të paraqitura nga pedagogët. *Pavarsisht kësaj <u>GVJ rekomandon</u> që lënda e praktikës duhet të evidentohet si veprimtari më vete në përmbajtjen e programit të studimit bazuar kjo dhe në VKM nr, 41, datë 24.01.2018, i ndryshuar "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë"* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

| Standardi III.3<br><br>**Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Procesi mësimor e shkencor, realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht. | GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitave të hapësirave vlerëson se procesi mësimor e shkencor i programit të studimit Master Profesional në "EU Business Law" realizohet në hapësira të mjaftueshme, të cilat janë të bollshme dhe mirëmbahen rregullisht. Godinat janë të pajisura me sistem ngrohje totale si në korridore dhe në zyra apo auditorë. Auditorët janë të pastra dhe me të gjitha kushtet për një zhvillim normal e dinjitoz të të gjithë aktiviteteve didaktike. |
| **Kriteri 2.** Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor dhe praktikave. | Njësia kryesore akademike përgjegjëse (Fakulteti i Drejtësisë) në bashkëpunim me strukturat e kësaj njësie ka bërë të mundur ofrimin e të gjithë mjediseve të nevojshme për realizimin me sukses të programit mësimor të studimit "Master Profesional European Business Law", duke zbatuar metodat bashkëkohore të mësimdhënies. Më saktësisht janë vendosur në dispozicion duke respektuar rregullat e distancimit social 12 auditore për zhvillimin e leksioneve dhe 13 salla për zhvillimin e seminareve.<br><br>*Evidenca nr. 2 "Statuti i Universitetit të Tiranës";*<br><br>*Evidenca nr. 26 "Auditorët e Fakultetit të Drejtësisë".* |
| **Kriteri 3.** Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor. | Njësia kryesore përgjegjëse për realizimin e programit të studimit "Master Profesional European Business Law" (Fakulteti i Drejtësisë) dhe njësia/të bazë përgjegjëse (departamenti i të drejtës Civile, Penale & Publike), kanë përcaktuar metodat bashkëkohore të mësimdhënies si: Leksione interaktive; Seminare/Ushtrime; Projekte/Detyrë kursi; Detyra; Ese. (Neni 6)<br><br>*Evidenca nr. 1 "Rregullorja e Programit të Studimit Master Profesional European Business Law";*<br><br>*Evidenca nr. 13 "Informacion mbi programin e studimit".*<br><br>*Evidenca nr. 23 "Aparaturat dhe pajisjet e FDUT"* |
| **Kriteri 4.** Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në | Për të gjitha lëndët ofrohen materiale në formë digjitale, të disponueshme online, nëpërmjet sistemeve të informacionit të vëna në dispozicion të studentëve si dhe maeriale të |

| | |
|---|---|
| gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit. | pritnuara apo botuara. Studentët orientohen drejt punës kërkimore individuale dhe projekteve.<br>*Evidenca nr. 13 "Informacion mbi programin e studimit".*<br>*Evidenca nr. 22 "Rregullore e brëndshme e Bibliotekës së FD"*<br>*Evidenca nr. 22.1 "Lista bibliografike e librave të rinj që kanë hyrë në fondin e Bibliotekës së FD, shtator 2019-korrik 2020"* |
| **Kriteri 5.** Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor. | Fakulteti ka në dispozicion 100 kompjutera, jo vetëm në Klinikën e Ligjit, por dhe në Bibliotekë, duke lehtësuar punën kërkimore të studentëve dhe aksesin e tyre në informacion. Gjithashtu, në të gjithë ambientet e Fakultetit mundësohet aksesi i lirë në internet.<br>*Evidenca nr. 22.1 "Lista bibliografike e librave të rinj që kanë hyrë në fondin e Bibliotekës së FD, shtator 2019-korrik 2020"*<br>*Evidenca nr. 23 "Për aparaturat dhe pajistet e FDUT".* |
| **Kriteri 6.** Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit. | Mjediset e fakultetit, përfshirë klinikën e ligjit dhe një sallë për të zhvilluar gjyqe imituese, janë të pajisura me: 15 kompjuter, 3 laptop, 2 TV, 1 projektorë, 4 mikrofonë etj.<br>Këto pajisje janë pjesë integrale e procesit të mësimit në programin e studimit, duke mbështetur të gjitha metodat bashkëkohore të mësimdhënies.Në bibliotekë ka mbi 10 (dhjetë) kompjutera në dispozicion të studentëve, përfshirë internet falas *wifi*, si dhe askses në bibliotekën online të mundësuar nga Ministria e Arsimit për Universitetin e Tiranës.<br>*Evidenca nr. 13 "Informacion mbi programin e studimit";*<br>*Evidenca nr. 23 "Për aparaturat dhe pajistet e FDUT";*<br>*Evidenca nr. 26 "Auditorët e Fakultetit të Drejtësisë".* |
| **Kriteri 7.** Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët. | Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, ka një klinikë ligji dhe një sallë për të zhvilluar gjyqe imituese. Këto mjedise janë të pajisura me: 10 projektorë në auditorët e Leksioneve, 2 Auditoret 202 dhe 402 jane të paisur me mikrofonë, 15 Wi-fi në të 4 katet e godinës, sistemi kamerave të monitoruara 24/7, Hollet e çdo kati janë të montuar TV për njoftime të ndryshme, Website wwwfdut.edu.al, Aplikacioni Androit dhe iOS, Rrjete Sociale për njoftime, etj. Këto pajisje janë pjesë integrale e procesit të mësimit në programin e studimit, duke mbështetur të gjitha metodat bashkëkohore të mësimdhënies. |

| | |
|---|---|
| | Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, ka 1 bibliotekë e cila është e organizuar sipas një sistemi bashkëkohor kërkimi dhe studimi. Kjo bibliotekë garanton mbështetjen e programit të studimit me materiale të përditësuara. Këto materiale konsistojnë në libra mësimorë, materiale digjitale didaktike, revista shkencore, etj. Në bibliotekë ka edhe mbi 10 (dhjetë) kompjutera në dispozicion të studentëve, përfshirë internet falas *ëifi.* Studentëve të Masterit EU Business Law u jepet askses edhe në bibliotekën online të mundësuar nga Ministria e Arsimit për Universitetin e Tiranës.<br>*Evidenca nr. 13 "Informacion mbi programin e studimit";*<br>*Evidenca nr. 23 "Për aparaturat dhe pajistet e FDUT";*<br>*Evidenca nr. 26 "Auditorët e Fakultetit të Drejtësisë".* |
| **Kriteri 8.** Në funksion të mësimdhënies, personelin akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre. | Komunikimi përmes Platformës Microsoft Teams që aplikohet në këtë program studimi lejon jo vetëm diskutimin dhe komunikimin interaktiv, por edhe publikimin e materialeve për studentët e programit. Është një mënyrë komunikimi që gjithashtu lejon monitorimin në kohë reale të këtyre publikimeve. Nga ana tjetër, sistemi i menaxhimit i ngritur për qëllime komunikimi, përmes rrugës elektronike, apo publikimeve në faqen zyrtare dhe/apo rrjetet sociale apo përmes Zyrës së Informacionit, gjithashtu lejon monitorimin e aktivitetit akademik dhe administrativ, duke lejuar mbledhjen në kohë reale edhe të çdo lloj problematike të raportuar. |
| **Kriteri 9.** Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar. | Nga komunikimi që patëm me studentët dhe stafin akademik rezultoi që çdo lloj aktiviteti dhe informacioni që nevojitet në kuadër të Programit të Studimit, qarkullohet në kohë reale jo vetëm përmes publikimit në faqen zyrtare online të institucionit, por edhe në rrugë elektronike nëpër adresat e deklaruara paraprakisht të stafit akademik dhe studentëve, ashtu si dhe publikohet në rrjetet sociale që administrohen nga ana e Fakultetit me qëllim informimin e studentëve, si dhe përmes Zyrës së Informacionit. Gjithashtu, stafi akademik komunikon në kohë reale me student e Programit përmes platformës *Microsoft Teams*. Në këtë mënyrë, njësia kryesore ka një sistem që garanton askses të plotë dhe të menjëhershëm në informacion. |
| **Kriteri 10.** Personeli akademik orienton studentët | Tema e Diplomës zgjidhet nga studenti në bashkëpunim me pedagogun, dhe i paraqitet për miratim një Komiteti |

| | |
|---|---|
| në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre. | Shkencor të ngritur *ad hoc* në çdo departament. Udhëheqësi shkencor studentin në bashkëpunim me zhvillojnë takime të herëpashershme duke verifikuar nëse respektohen kriteret e shkrimit akademik, ruajtja e integritetit etik në kërkim, sipas udhëzuesve të miratuar nga Departamenti përkatës. (Neni 45)<br>*Evidenca nr. 1 "Rregullorja e Programit të Studimit Master Profesional European Business Law";*<br>*Evidenca nr. 18 "Mbi ngritjen e komisioneve ad hoc nga Departamentet përgjegjëse";*<br>*Evidenca nr. 21 Udhëzues "Mbi strukturën dhe rregullat e shkrimit të tezës së masterit";* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi III.4**<br>**Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë, aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. | Universiteti i Tiranës në statutin e tij ka përcaktuar Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë (KPSSC) për vlerësimin periodik të rezultateve të veprimtarive mësimore. KPSSC planifikon dhe organizon Vlerësimin e Brendshëm të Cilësisë, në kuadër të Universitetit të Tiranës", në dy aspekte kryesore:<br>1. Vlerësimin e Brendshëm të Cilësisë të programeve të studimit;<br>2. Vlerësimin e Brendshëm Institucional;<br>Mënyra e funksionimit të sistemit të sigurimit të cilësisë përcaktohet në Rregulloren e Sigurimit të Cilësisë në nivel institucioni dhe në rregulloret e sigurimit të cilësisë së secilës njësi kryesore. KPSSC bashkëpunon me Dekanët e Fakulteteve dhe me Degën e sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe karrierës në FD, për çdo vlerësim te brendshëm të cilësisë që organizon. Rezultatet e Raporteve të vlerësimit të KPSSC shërbejnë si bazë për zyrën e kërkimit shkencor për të hartuar dhe zbatuar programe të zhvillimit pedagogjik dhe didaktik të personelit akademik. |

| | |
|---|---|
| | *Evidenca nr. 2 "Statuti i Universitetit të Tiranës, neni 138";*<br><br>*Evidenca nr. 4"Strategjia e Zhvillimit të Universitetit të Tiranës 2018-2023";*<br><br>*Evidenca 62 – Komisioni i përhershëm për sigurimin e standardeve të cilësisë, Vendim Nr. 10, Datë 11.04.2019 i Senatit Akademi .pdf* |
| **Kriteri 2.** Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron. | Fakulteti i Drejtësisë, si njësia kryesore pranë të cilit ofrohet programi i studimit "Master Profesional European Business Law", ka përvojë akademike shumë vjecare në fushën e studimeve juridike, në të cilën ofrohet dhe ky program studimi. Fakulteti i Drejtësisë ofron programe studime në të tre ciklet e studimit dhe ka kapacitetin e duhur akademik dhe shkencor për të gjitha këto programe studimi. Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi përbëhet nga personel akademik i kategorisë "Profesor" si dhe "Lektor" i punësuar me kohë të plotë ose të pjesshme. Për lëndë specifike, këto kategori personeli kombinohen me specialistë me përvojë profesionale në fushën e të drejtës së BE-së.<br><br>*Evidenca nr. 1 "Programi i Studimit të Masterit Profesional në "European Business Law"*<br><br>*Evidenca nr. 10 "Rregullorja e Brendshme për organizimin e programit rajonal të Masterit për të drejtën e biznesit të BE-së";*<br><br>*Evidenca nr. 13 Tabela 4 "Mbi personelin akademik të angazhuar në programin e studimit "Master Profesional European Business Law".*<br><br>*Evidenca nr.18.1 "Marrëveshja e bashkëpunimit për organizimin dhe zvhillimin e programit rajonal të masterit në të drejtën e biznesit të BE-së ;* |
| **Kriteri 3.** Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies. | Universiteti i Tiranës ka një udhëzues strategjik për periudhën 2018-2023 për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies. Në këtë strategji FD luan një rol kryesor duke kontribuar në ndërtimin e platformave të reja mësimdhënie. Programi i studimit në të drejtën e BE-së është një program ndërdisiplinor (bazuar dhe në strategjinë e zhvillimit të UT-së, (fq. 7) dhe përputhet me fushën e përgjithshme dhe specifike të fushave të studimeve që ofrohen nga Departamenti i të Drejtës Civile, Penale & Publike (si njësitë bazë përgjegjëse për këtë program studimi). Hapja e këtij programi studimi është realizuar fillimisht përmes një konsorciumi rajonal të mbështetur nga Fondi i Hapur |

| | |
|---|---|
| | Rajonal, GTZ për Europën Juglindore. Ky master u krijua si pjesë e një masteri rajonal me lektorë vendas e të huaj dhe një pjesë e lëndëve u ofrua në gjuhën angleze. Për realizimin e programit "Master Profesional EU Business Law" janë parashikuar metodat e mëposhtme të mësimdhënies:<br>□ Leksione interaktive;<br>□ Seminare/Ushtrime;<br>□ Projekte/Detyrë kursi;<br>□ Detyra;<br>□ Ese.<br><br>*Evidenca nr. 13 "Informacion mbi programin e studimit";*<br>*Evidenca nr. 13, Pika 5 - Tabela e planit mësimor "Informacion mbi programin e studimit".*<br>*Evidenca 4. Strategjia e Zhvillimit të Universitetit të Tiranës 2018 – 2023.pdf* |
| **Kriteri 4.** Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. | Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, Departamenti i së Drejtës Pubike, Departamenti i së Drejtës Civile dhe Departamenti i së Drejtës Penale, si njësitë bazë për realizimin e këtij programi studimi, mbështeten financiarisht nga institucioni dhe administrojnë të ardhurat nga aktivitete të ndryshme. UT-ja zotëron burime të mjaftueshme dhe të qëndrueshme financiare, të cilat bëjnë të mundur funksionimin e programit dhe garantojnë zhvillimin e vazhdueshëm të tij. Përveç të ardhurave buxhetore, UT-ja synon të rrisë të ardhurat nëpërmjet realizimit të projekteve të ndryshme. Menaxhimi i burimeve financiare bëhet në funksion të garantimit të cilësisë. Mbështetja për sa më sipër realizohet përmes mbështetjes në konferencat shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare; pjesëmarrje të personelit akademik në projekte, pjesëmarrjen në trajnime apo tryeza diskutimesh etj.<br>*Evidenca nr. 2 "Statuti i UT";*<br>*Evidenca nr.5 "Plani i Kërkimit Shkencor të Universitetit të Tiranës 2017-2022".*<br>*Evidenca nr. 35 – Vendimi nr.12 datë 07.04.2022 I BA të UT "Mbi miratimin e Buxhetit të vitit 2022 të UT-së"* |
| **Kriteri 5.** Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë | Departamentet përgjegjëse për këtë program studimi, organizojnë dhe administrojnë veprimtari akademike dhe të |

| | |
|---|---|
| vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja. | kërkimit shkencor, duke respektuar liritë akademike të personelit dhe të drejtën për të shfrytëzuar burimet materiale dhe financiare në dispozicion. Personeli akademik harton plane pune, informacione dhe raporte semestrale e vjetore, të cilat depozitohen në Dekanat.<br><br>Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës:<br><br>o mundëson zhvillimin e veprimtarive kërkimore në vijimësi;<br>o bashkërendon punën kërkimore në departamente;<br>o promovon veprimtarinë kërkimore–shkencore brenda e jashtë vendit;<br>o nxit pedagogët për punë kërkimore dhe për pjesëmarrje në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare;<br>o ndjek zbatimin e orientimeve, të planeve, të projekteve dhe tematikës së miratuar në departamente,<br>o raporton në Senat.<br><br>*Evidenca nr.2 "Statuti i Universitetit të Tiranës";* |
| **Kriteri 6.** Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja. | Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik i njësive bazë, përgjegjëse për zbatimin e programit të studimit janë të angazhuar për të përmirësuar mësimdhënien dhe zbatimin e metodave të reja të mësimdhënies. Kjo përfshin përzgjedhjen e lektorit më të përshtatshëm për lëndët, duke ofruar sugjerimet e duhura në mënyrë që lëndët specifike të ofrojnë mbështetje më të mirë nga stafi me ekspert. Personeli akademik ka realizuar me sukses programin e studimit. Ata angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies duke marrë pjesë në trajnime të organizuar nga institucioni dhe marrë në konsideratë rekomandimet e studentëve. Personeli akademik i angazhuar në këtë program është i kategorisë "Profesor" dhe "Lektor" me kohë të plotë ose të pjesshme me përvojë në fushën e të Drejtës së BE-së.<br><br>*Evidenca nr. 13 Tabela 4 "Mbi personelin akademik të angazhuar në programin e studimit "Master Profesional "European Business Law;*<br><br>*Evidenca nr. 28 "Dosja e plotë didaktike".* |
| **Kriteri 7.** Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë | Universiteti i Tiranës, bazuar në nenin 37, pika 1, të Ligjit nr. 80/2015, *"Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"*, neni 30 pika 1, të Statutit të UT-së; me vendimin e datës 25.11.2021, Senati Akademik i UT-së, ka miratuar ngritjen |

| | |
|---|---|
| efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse. | e Qendrës Virtuale të Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit në Universitetin e Tiranës. Përmes klësaj qendre ofrohen trjnime të vijueshme për personelin akademik. Shih: https://unitir.edu.al/qender-virtuale-e-trajnimit-dhe-zhvillimit-profesional/<br><br>*Evidenca nr. 25 "Krijimi i Qendrës Virtuale të Trajnimit nëUT – Vendim i Senatit UT nr.48";*<br><br>*Evidenca nr. 25 "Trajnimet e ofruara nga Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit në Universitetin e Tiranë";*<br><br>*Evidenca nr. 27 "Informacion i detajuar mbi takimet dhe aktivitetet e zhvilluara nga Fakulteti i Drejtësisë".* |
| **Kriteri 8.** Institucioni në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. | Institucioni mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.<br><br>Veprimtaria kërkimore-shkencore në Departamentet përgjegjëse për kërë program studimi realizohet mbi bazën e grupeve lëndore. Institucioni, përmes marrëveshjeve të bashkëpunimit që ka realizuar me institucionet partnere, ka mbështetur mobilitetin e stafit akademik dhe të studentëve. Kjo eksperience i ka shërbyer përmirësimit të infrastrukturës akademike duke zhvilluar më tej kurrikulën e lëndëve/moduleve, si dhe kërkimit shkencor. Këto Departamente bashkëpunojnë edhe me çdo institucion apo qendër kërkimore shkencore që ofron ekspertizë në fushën e së Drejtës së Biznesit në BE.<br><br>*Evidenca nr. 20 "Tabela e Marrëveshjeve të bashkëpunimit të Fakultetit të Drejtësisë me institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare gjatë vitit akademik 2020-2021 & 2021-2022".* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi III.5**<br><br>**Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët. | Mënyra e vlerësimit dhe zhvillimit të testimeve përcaktohet qartë ne Rregullorene programit të studimit si dhe në syllabuset e lëndëve përkatëse. Sipas Rregullores së UT-së (*neni 57*) vlerësimi në një lëndë mund të bëhet me provim me shkrim, me gojë ose i kombinuar; ese, prezantime, projekte dhe forma të tjera të vlerësimit. Provimet zhvillohen brenda afatit të caktuar në Kalendarin e Vitit Akademik. Vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm. (*Neni 35 i Rregullores së programit Master*).<br>*Evidenca nr. 1 "Rregullorja e Programit të Studimit "Master Profesional European Business Law";*<br>*Evidenca nr 3 "Rregullorja e UT-së".*<br>*Evidenca nr. 28 "Dosja e plotë didaktike".* |
| **Kriteri 2.** Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. | Format dhe kriteret e vlerësimit përcaktohen në programin e çdo lënde dhe i bëhen të ditura studentit në fillim të semestrit. Këto forma vlerësimi mund të jenë: me provim me shkrim/gojë ose i kombinuar; essay/prezantime/projekte, si dhe forma të tjera.<br>*Evidenca nr. 1 "Rregullorja e Programit të Studimit "Master Profesional European Business Law".*<br>*Evidenca nr. 3 "Rregullorja UT"*<br>*Evidenca nr. 28 "Dosja e plotë didaktike".* |
| **Kriteri 3.** Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara. | Në bazë të rregullores së UT-së (*neni 57*), dhe Rregullores së programit Master (*Neni 34*) kontrolli i dijeve dhe instrumentet e vlerësimit bazohen në element si: kriteri i vlerësimit, që përshkruan atë çfarë pritet të përfitojë studenti dhe në çfarë niveli, me qëllim demonstrimin e arritjeve të rezultateve të të nxënit për një lëndë të dhënë ;si dhe metodat e vlerësimit, që janë teknikat, mjetet dhe instrumentet për grumbullimin e informacionit për të përcaktuar masën, në të cilën studenti përvetëson rezultatet e të nxënit të një lënde. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi III.6** |
|---|

| Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti.. | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar. | Në bazë të rregullores së UT (*neni 57*), dhe Rregullores së programit Master (*Neni 35*) studenti testohet dhe vlerësohet përgjatë gjithë semestrit akademik, sipas një kalendari të përcaktuar nga njësia bazë (për provimet përfundimtare) dhe sipas një kalendari të përcaktuar nga pedagogët e lëndëve (për provimet/testimet e ndërmjetme).<br><br>Në syllabuset e çdo lënde janë të përcaktuara kriteret e vlerësimit për gjatë gjithë semestrit, temat për detyrat e kursit shpallen brenda përfundimit të semestrit akademik.<br><br>*Evidenca nr. 1 "Rregullorja e Programit të Studimit "Master Profesional European Business Law".*<br><br>*Evidenca nr. 3 : Rregullorja e UT-së*<br><br>*Evidenca nr. 28 "Dosja e plotë didaktike".* |
| **Kriteri 2.** Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën. | Në bazë të rregullores së UT-së (*neni 59*), dhe Rregullores së programit Master *(Neni 35)* provimet zhvillohen me procedurë sekretimi duke mbajtur të fshehtë emrin e studentit në fletën e provimit. Vlerësimi i studentit me pikë shënohet në fletën e provimit dhe firmoset nga pedagogu që ka bërë korrigjimin në formatin përmbledhës të vlerësimit të studentëve.<br><br>*Evidenca nr. 1 "Rregullorja e Programit të Studimit "Master Profesional European Business Law".*<br><br>*Evidenca nr. 3 "Rregullorja e UT-së";*<br><br>*Evidenca nr. 28"Dosja e plotë didaktike";* |
| **Kriteri 3.** Testimi e vlerësimi përfundimtar i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit. | Vlerësimi i dijeve të studentëve bazohet në kriteret dhe komponentët e përcaktuar në syllabusin e çdo lënde. Nota përfundimtare është rezultat i totalit të pikëve të marra nga komponentët e vlerësimit të dijeve dhe vlerësimi bazohet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm të tyre. Në procesverbalet e kontrolluara në kampion rezulton që komisionet e provimit janë të përbër nga së paku 2 anëtarë të stafit akademik (titullari i lëndës dhe asistenti, ose titullar i një lënde të përafërt) |
| **Kriteri 4.** Testimi i vlerësimit të njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë | Në bazë të rregullores së UT-së (*neni 59*), dhe Rregullores së programit Master (*Neni 35*) provimet zhvillohen me |

| | |
|---|---|
| anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi. | procedurë sekretimi duke mbajtur të fshehtë emrin e studentit në fletën e provimit.<br><br>*Evidenca nr. 1 "Rregullorja e Programit të Studimit "Master Profesional European Business Law".*<br><br>*Evidenca nr. 3 "Rregullorja e UT-së";* |
| **Kriteri 5.** Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen. | Stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi e realizon procesin e vlerësimit të studentëve, për çdo komponent vlerësimi, nëpërmjet pikëzimit dhe shënimeve apo komenteve përkatëse, të cilat i bëhen të njohura studentëve individualisht.<br><br>Në bazë të rregullores së UT-s *(Neni 60)* dhe Rregullores së programit Master (*Neni 37*) pas shpalljes së rezultateve të vlerësimit, kryhen sqarime, nëse ka pasur kërkesa për sqarim nga studentët si dhe respektohen të drejtat e studentëve për rishikim të provimit, marrje të fotokopjes së zgjidhjes që ka bërë (në rastet kur nuk është i bindur me sqarimet e komisionit) e deri në ngritjen e komisionit të rivlerësimit të provimit në rast ankimimi të mëtejshëm.<br><br>*Evidenca nr. 1 "Rregullorja e Programit të Studimit "Master Profesional European Business Law";*<br><br>*Evidenca nr. 3 "Rregullorja e UT-së".* |
| **Kriteri 6.** Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra. | Gjatë zhvillimit të provimeve bazuar në thëniet e stafit akademik gjatë intervistës së zhvilluar rezulton se vëmëndja është maksimale për mos të lejuar asnjë formë kopjimi. Kjo sigurohet nga titullari i lëndës dhe anëtari i dytë i komisionit të provimit. |
| **Kriteri 7.** Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse. | Vlerësimi i dijeve të studentëve bazohet në kriteret dhe komponentët e përcaktuar në syllabusin e çdo lënde. Nota përfundimtare është rezultat i totalit të pikëve të marra nga komponentët e vlerësimit të dijeve dhe vlerësimi bazohet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm të tyre.<br><br>*Evidenca nr. 1 "Rregullorja e Programit të Studimit Master Profesional European Business Law";*<br><br>*Evidenca nr. 28 "Dosja e plotë didaktike";* |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 8.** Instituciooni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. | Në bazë të "Rregullores së UT-s", (*neni 62)* dhe Rregullores së programit Master (*Neni 37*) në rast se studenti ka ankesë për pikët që ka marrë në një nga komponentët e vlerësimit (provim i ndërmjetëm, detyrë kursi, provim përfundimtar), pasi të ketë konsumuar procedurën e konsultimit me pedagogun e lëndës, ai mund t'i drejtojë Përgjegjësit të Departamentit përkatës kërkesë me shkrim, ku të parashtrojë arsyet mbi të cilat ai bazon ankesën. Përgjegjësi brenda 24 orëve, nga data e depozitimit të ankimit, njofton personelin akademik të lëndës, që të bëjnë shqyrtimin e dhe merr vendim me shumicën e përbërjes së tij. Vlerësimi i Komisionit është përfundimtar dhe mund të jetë i njëjtë, më i lartë ose më i ulët se vlerësimi i kontestuar.<br><br>*Evidenca nr. 1 "Rregullorja e Programit të Studimit Master Profesional European Business Law".*<br><br>*Evidenca nr. 3 "Rregullorja e UT-së";* |
| **Kriteri 9.** Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet. | Rregullorja e UT, përkatësisht *nenet 50 dhe 51* kane të përcaktuara të gjitha detajet mbi ankimin e vlerësimit. Studenti ka të drejtë të ankohet për mos plotësimin e rregullave të provimit dhe të vlerësimit të tij.<br><br>Vlerësimi i studentit me pikë shënohet në fletën e provimit dhe firmoset nga pedagogu që ka bërë korrigjimin në formatin përmbledhës të vlerësimit të studentëve. Pedagogu i pret studentët për të sqaruar çdo ankesë apo pretendim të mundshëm që ata mund të kenë lidhur me vlerësimin. Pas këtij afati pedagogu plotëson dhe dorëzon procesverbalin përfundimtar në Sekretari, i cili mban firmën e titullarit të lëndës dhe asistentit nëse ka të tillë, sekretares dhe Përgjegjësit të Departamentit. Tezat e provimit formulohen nga titullari i lëndës dhe aprovohen nga Përgjegjësi i Departamentit.<br><br>*Evidenca nr. 1 "Rregullorja e Programit të Studimit "Master Profesional European Business Law".*<br><br>*Evidenca nr. 3 "Rregullorja e UT-së";* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi III.7**<br><br>**Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve. | Programi i studimit "Master Profesional European Business Law", si një program i ciklit të dytë të studimeve, ofron njohuri të thelluara akademike në fushën përkatëse. Ky program studimi synon të ofrojë dije të konsoliduara në aspektin teorik, duke mundësuar studime të pavarur në fushën përkatëse kërkimore shkencore (në fushën e të Drejtës së Biznesit të BE-së).<br><br>Fusha studimore në të cilën ky program studimi ofrohet është multidisiplinore dhe ndërsektoriale. Kjo mundëson për të diplomuarit njohuri dhe kompetenca nga këndvështrimi multidisiplinor, duke mundësuar për ta aftësitë e të menduarit kritik dhe të zhvillimit strategjik në fushën e të Drejtë së Biznesit të BE-së.<br><br>*Evidenca nr. 13 "Informacion mbi programin e studimit"* |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, të komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj). | Programi i studimit "Master Profesional European Business Law" ofron përmes lëndëve specifike njohuri të veçanta komunikuese si lënda "E drejta dhe Institucionet e BE-së", "E drejta e tregut të brendshëm" , E drejta e Konkurrencës të BE-së, E drejta e Konsumatorit të BE-së" etj.<br><br>*Evidenca nr.13 "Informacion mbi programin e studimit Master Profesional European Business Law";*<br><br>*Evidenca nr.28 "Dosja e plotë didaktike".* |
| **Kriteri 3.** Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde. | Qysh në fillim të zhvillimit të programit të lëndës, studenti njihet me përmbajtjen e syllabusit të hartuar nga titullari i lëndës. Në realizim të programit mësimor, për çdo lëndë të veçantë, analizohen e shqyrtohen kompetencat dhe aftësitë e fituara nga studenti në testet dhe vlerësimet përkatëse, në diskutimet për to si dhe duke tërhequr vlerësimet e të diplomuarve e të punësuarve në këtë PS. Mbi këtë bazë bëhen edhe plotësimet e përmirësimet në syllabuse në masën deri 20%. |
| **Kriteri 4.** Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet | Syllabuset e çdo lënde të kurrikulës së programit të studimit "Master Profesional European Business Law" pasqyrojnë qartë objektivat dhe kompetencat përkatëse që synohen të |

| | |
|---|---|
| më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar. | përftohen nga studentët. Stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi informon studentët përmes syllabuseve për kriteret e vlerësimit dhe mënyrën e përgatitjes nga ana e tyre të detyrave apo detyrimeve të tjera akademike. |
| **Kriteri 5.** Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit. | Ky program studimi nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë me zhvillimin e shkencës dhe teknologjisë. Rezultojnë të reflektuara në syllabuset e lëndëve ndryshimet legjislative përkatëse dhe të literaturës përsa i përket zhvillimeve në Bashkimin Europian. |
| **Kriteri 6.** Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. | Ky program studimi nuk përfshin punë laboratorike dhe orë praktike të veçanta. |
| **Kriteri 7.** Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara. | Ky program studimi plotëson nevojën në rritje për formim shkencor të thelluar me qëllim aftësimin e studentin për një kërkim të pavarur shkencor në fushën e studimeve të të drejtës së BE-së si dhe zhvillon tek ata aftësinë e të menduarit kritik, për të qenë të suksesshëm në karrierën e tyre në fushën e të drejtës së Bashkimit Europian si dhe mundëson zgjerimin e dijeve në fushën e legjislacionit tregtar, vendas dhe evropian, duke i mëshuar aspekteve teorike të mësimnxënies në këtë fushë.<br>*Evidenca nr. 13 "Informacion mbi programin e studimit Master Profesional European Business Law".* |
| **Kriteri 8.** Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet. | Personeli akademik i programit të studimit dëshmon aftësi profesionale të larta për krijimin e një klime të përshtatshme të zhvillimit të ideve innovative dhe studimeve të avancuara kërkimore dhe shkencore. Programi i studimit "Master Profesional European Business Law" është hartuar në funksion të zhvillimit të kompetencave teorike. Kompetencat e përftuara në këtë program studimi synojnë të zhvillojnë njohuri të thelluara dhe të avancuara në fushën përkatëse. Ato mundësojnë për studentët një formim ndërdisiplinor. |

| | |
|---|---|
| | *Evidenca nr. 37 – CV-të e pedagogëve të angazhuar në mësimëdhënie në programin "Master pofesional" në "Europena Business Law"* |
| **Kriteri 9.** Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato. | Për të gjitha lëndët ofrohen materiale në formë digjitale, të disponueshme online, nëpërmjet sistemeve të informacionit të vëna në dispozicion të studentëve si dhe maeriale të pritnuara apo botuara. Studentët orientohen drejt punës kërkimore individuale dhe projekteve.<br>*Evidenca nr. 35 Vendimi nr. 12, datë 7.4.2022, i Bordit të Administrimit, Universiteti i Tiranës "Mbi miratimin e Buxhetit të vitit 2022 të UT-së";*<br>*Evidencë nr. 36"Analiza e Realizimit të Buxhetit për Vitin 2021 dhe detajimi i planit për vitin 2022, e Administratorit të Fakultetit të Drejtësisë, drejtuar Dekanit të Fakultetit të Drejtësisë".* |
| **Kriteri 10.** Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve. | GVJ ka konstatuar se Universiteti i Tiranës ka marrë pjesë në disa projekte ERASMUS+. Nëpërmjet tyre institucionin mundëson rritjen e shkëmbimit te eksperiencës dhe përfitimin prej praktikave më të mira të institucioneve bashkëpunuese perëndimore, njohuri te cilat më pas aplikohen në auditor apo transferohen tek anëtare te tjerë te personelit akademik.<br>*Evidenca 103 – Marrëveshje në kuadër të programit Erasmus + dhe Marrëveshje Bilaterale.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi III.8**<br>**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përftimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizmin e praktikës | Ky program studimi nuk parashikon orë praktike si veprimtari formuese në përbërje të tij.<br>Si pjesë e organikës së FDUT-së është dhe Klinika e Ligjit, *nuk rezulton asnjë e dhënë që Klinika e Ligjit të jetë në funksion dhe të këtij programi studimi.* |

| | |
|---|---|
| laboratorike, praktikës profesionale. | |
| **Kriteri 2.** Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin sa më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale. | GVJ konstaton që ky program studimi nuk parashikon orë praktike si veprimtari formuese në përbërje të tij në përputhje me *VKM nr, 41, datë 24.01.2018, i ndryshuar "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë"*. Në takimet e zhvilluara nga GVJ në institucion u evidentua që pavarësisht kësaj mangësie të konstatuar, pedagoët e lëndëve zhvillojnë orë të praktikës teorike brënda programit të tyre mësimor, në formën e trajtimit të kazusëve apo situatave të ndryshme të simuluara. |
| **Kriteri 3.** Praktikat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës. | Ky program studimi nuk parashikon orë praktike si veprimtari formuese në përbërje të tij në përputhje me *VKM nr, 41, datë 24.01.2018, i ndryshuar "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë"..* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

| **Standardi III.9**<br><br>**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para | Sipas Rregullores së UT-së (*neni 57)* vlerësimi në një lëndë mund të bëhet me provim me shkrim, me gojë ose i kombinuar; ese, prezantime, projekte dhe forma të tjera të vlerësimit. Provimet zhvillohen brenda afatit të caktuar në Kalendarin e Vitit Akademik. Vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm. (*Neni 35 i* |

| | |
|---|---|
| diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike. | *Rregullores së programit Master*). Format dhe kriteret e vlerësimit të studentit përcaktohen në programin e çdo lënde dhe i bëhen të ditura paraprakisht studentëve.<br><br>Në bazë të rregullores së UT-s (*Neni 60*) dhe Rregullores së programit Master (*Neni 37*) pas shpalljes së rezultateve të vlerësimit, kryhen sqarime, nëse ka pasur kërkesa për sqarim nga studentët si dhe respektohen të drejtat e studentëve për rishikim të provimit, marrje të fotokopjes së zgjidhjes që ka bërë (në rastet kur nuk është i bindur me sqarimet e komisionit) e deri në ngritjen e komisionit të rivlerësimit të provimit në rast ankimimi të mëtejshëm.<br><br>*Evidenca nr. 1 "Rregullorja e Programit të Studimit "Master Profesional European Business Law";*<br><br>*Evidenca nr 3 "Rregullorja e UT-së".* |
| **Kriteri 2.** Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës. | Procedura për realizimin e detyrimeve përmbyllëse është përcaktuar në "Rregulloren e programit të studimit" (*Neni 41 dhe 44),* duke specifikuar si detyrim përmbyllës temën e diplomës. Tema e diplomës duhet të jetë një punim i pavarur krijues që synon të vërtetojë aftësitë dhe kompetenca profesionale të studentit.<br><br>Njësitë përgjegjëse për programin e studimit "Master Profesional European Business Law" ngrenë komisone *ad hoc* për udhëzimin për temën e diplomës e cila drejtohet nga një prej pedagogëve të këtij masteri dhe tema e përfunduar mbrohet para një komisioni i ngritur nga Departamenti, i cili përbëhet nga 3 (tre) anëtarë. Në realizimin e vlerësimit Komisioni siguron respektimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi në lidhje me etikën e kërkimit shkencor dhe plagjaturën. Versioni përfundimtar i Temës së Diplomës, pas reflektimit të vërejtjeve të Ko misionit të Vlerësimit, ruhet në departament.<br><br>*Evidenca nr. 1 Rregullorja e Programit të Studimit "Master Profesional European Business Law";*<br><br>*Evidenca nr. 3 "Rregullorja e UT-së ";*<br><br>*Evidenca nr. 18 "Mbi ngritjen e komisioneve ad hoc nga Departamentet përgjegjëse"*<br><br>*Evidenca nr. 21 Udhëzues "Mbi strukturën dhe rregullat e shkrimit të tezës së masterit"* |
| **Kriteri 3.** Komisioni i posaçëm për administrimin e | Ky program studimi zgjat 1 vit akademik. Procedura për realizimin e detyrimeve përmbyllëse është përcaktuar në "Rregulloren e programit të studimit" (*Neni 41 dhe 44),* duke |

| | |
|---|---|
| provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike. | specifikuar si detyrim përmbyllës temën e diplomës. Tema e diplomës duhet të jetë një punim i pavarur krijues që synon të vërtetojë aftësitë dhe kompetenca profesionale të studentit. |
| **Kriteri 4.** Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të studimit/diplomave. | Njësitë përgjegjëse për programin e studimit "Master Profesional European Business Law" ngrenë komisone *ad hoc* për udhëzimin për temën e diplomës e cila drejtohet nga një prej pedagogëve të këtij masteri dhe tema e përfunduar mbrohet para një komisioni i ngritur nga Departamenti, i cili përbëhet nga 3 (tre) anëtarë.<br>*Evidenca nr. 1 Rregullorja e Programit të Studimit "Master Profesional European Business Law";*<br>*Evidenca nr. 21 Udhëzues "Mbi strukturën dhe rregullat e shkrimit të tezës së masterit"*<br>*Evidenca nr. 18 "Mbi ngritjen e komisioneve ad hoc nga Departamentet përgjegjëse"* |
| **Kriteri 5.** Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit. | Bazuar në rregulloren e UT-së (*neni 68*) dhe në Rregulloren e programit (*Neni 45*) departamentet krijojnë komision *ad hoc* për udhëzuesin për hartimin e temës i cili përcakton rregullat e shkrimit, punës eksperimentale, citimit dhe shkrimit të literaturës, rezultateve dhe diskutimeve, përpunimit statistikor, përpunimit të tabelave dhe figurave, etj. |
| **Kriteri 6.** Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit. | Tema e Diplomës zgjidhet nga studenti në bashkëpunim me pedagogun, dhe i paraqitet për miratim një Komiteti Shkencor të ngritur *ad hoc* në çdo departament. Udhëheqësi shkencor studentin në bashkëpunim me zhvillojnë takime të herëpashershme duke verifikuar nëse respektohen kriteret e shkrimit akademik, ruajtja e integritetit etik në kërkim, sipas udhëzuesve të miratuar nga Departamenti përkatës. (*Neni 45*)<br>*Evidenca nr. 1 "Rregullorja e Programit të Studimit Master Profesional European Business Law";* |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 7.** Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë. | Në bazë të rregullores së UT-s, vlerësimi i diplomës bëhet me sistemin nga nota pakaluese 4 (katër) deri në notën maksimale 10 (dhjetë). Nota kaluese më e ulët është nota pesë. |
| **Kriteri 8.** Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. | Bazuar në rregulloren e programit (*Neni 46*) studenti në përfundim të studimeve dhe mbrojtjes së diplomës pajiset me diplomën dhe suplementin e saj, të miratuara me Udhëzimin Nr. 11, datë 02.04.2020 të Ministres së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe të Vendimit të Senatit Akademik të UT-së Nr. 28, datë 21.10.2020 "Për miratimin e përmbajtjes dhe formës së suplementit të diplomës.<br>*Evidenca nr.15 "Udhëzim Nr. 11, datë 2.4.2020 Për përcaktimin e përmbajtjes dhe të formës së suplementit të diplomës + modeli i suplementit dhe nje kopje diplome (e anonimuar)";*<br>*Evidenca nr. 1 "Rregullorja e Programit të Studimit Master Profesional European Business Law";*<br>*Evidenca nr. 3 "Rregullorja e UT-së"* |
| **Kriteri 9.** Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar. | Me kërkesë të studentit sekretaria mësimore ivë në dispozicion kopje të plotë zyrtare tëprogramit të studimit të zhvilluar |
| **Kriteri 10.** Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentët nëse kërkohen. | Njësia kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit Master Profesional angazhohen për ruajtje e dokumentacionit të përcaktuar për ruajtje pa afat dhe atë të përcaktuar për ruajtje me afat të përcaktuar, sipas legjislacionit në fuqi.<br>*Evidenca nr.40 "Urdhri Nr.12 datë 08.6.2015 "Mbi Miratimin e Rregullores "Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në Universitetin e Tiranës";* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

## IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

| **Standardi IV.1**<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1** Institucioni i arsimit të lartë mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ. | Personeli akademik i angazhuar në këtë program është i kategorisë "Profesor" dhe "Lektor" me kohë të plotë ose të pjesshme me përvojë në fushën e të Drejtës së BE-së. Stafi akademik (PAE) ka një eksperiencë disa vjecare punësimi pranë njësive përkatëse akademike. IAL administron të dokumentuar curriculen vitae të secilit prej tyre. Ky program studimi. Sipas Vendimit të Dekanit nr.28, datë 01.12.2021, me numër protokolli 991/3, si zëvendës dekan i Fakultetit të Drejtësisë, Universitetit të Tiranes, për programin e Ciklit të dytë Master, është emëruar Dr. J. B., personel akademik me kohë të plotë pranë Departamentit të së Drejtës Penale të këtij Fakulteti. Dr. Bara është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit Master Profesional ne EU Business Law, në përputhje me objektivat e tij.<br><br>*Evidenca nr. 13 Tabela 4 "Mbi personelin akademik të angazhuar në programin e studimit "Master Profesional "European Business Law;*<br><br>*Evidenca nr. 13 Tabela 5 "Mbi lëndët dhe pedagogët në programin e studimit "Master Profesional European Business Law";*<br><br>*Vendimi i Dekanit nr.28, datë 01.12.2021, me numër protokolli 991/3.* |
| **Kriteri 2** Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit. | Nga evidencat e paraqitura dhe verifikimi në Institucion, Departamentet zbatojnë procedura të përcaktuara qartë për rekrutimin e personelit akademik të cilat janë të sanksionuara në Statut, Rregullore të UT dhe në kornizën ligjore në fuqi.<br><br>Stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi është kryesisht i punësuar pranë FD mbi 10 vite akademike. Kjo e dhënë deduktohet nga CV e paraqitura të stafit akademik. Rezulton se për angazhimin e stafit akademik (PAE & PAK) në programin e studimit "Master Profesional European Business Law", njësia kryesore (Fakulteti i Drejtësisë) dhe njësia/të bazë përgjegjëse kanë aplikuar procedurat e bazuara në aktet ligjore në fuqi dhe në aktet e brendshme administrative, të cilat janë miratuar nga drejtuesit përkatës të njësive |

| | |
|---|---|
| | *Evidenca nr. 2 "Statuti i Universitetit të Tiranës";*<br><br>*Evidenca nr. 13 Tabela 4 "Mbi personelin akademik të angazhuar në programin e studimit Master Profesional European Business Law".*<br><br>*Evidenca nr. 37 – CV-të e pedagogëve të angazhuar në mësimëdhënien e MP "EU Business Law"* |
| **Kriteri 3** Institucioni i arsimit të lartë harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike. | Njësia bazë, mbështetur në nevojat e saj, përcakton kritere të veçanta për vendet e punës, mbështetur mbi kategorinë e personelit që kërkon të punësohet, të cilat miratohen nga Rektori. Këto kritere i përcillen Rektorit nga drejtuesi i njësisë kryesore (*neni 67, pika 3 e Statutit të UT*).<br><br>Rektori në rastet kur konstaton kritere në kundërshtim me ligjin, i kthen edhe një herë për rishyrtim nga njësia bazë përkatëse. Rektori përcjell pranë njësive bazë miratimin e kritereve të punësimit dhe autorizon vazhdimin e procedurave të konkursit për vendin e punës për personel akademik me kohë të plotë. Drejtuesi i njësisë bazë bën shpalljen e konkursit në APP si dhe në faqen zyrtare të njësisë. Procedura e rekrutimit kalon nëpër faza transparente konkurrimi, sipas afateve të përcaktuara në kuadrin normative rregullator.<br><br>*Evidenca nr. 2 "Statuti i Universitetit të Tiranës";*<br><br>*Evidenca nr. 13 Tabela 4 "Master Profesional European Business Law"* |
| **Kriteri 4** Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit. | Kriteret e përgjithshme të rekrutimit janë të përcaktuara në *nenin 68, pika 3* të Statutit të UT-së dhe *nenin 26* të Rregullores së UT. Njoftimi për nevojën për personel akademik bëhet publik nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të njësisë kryesore, pjesë e së cilës është njësia (pika 6, neni 68 i Statutit të UT –së) dhe përzgjedhja i nënshtrohet respektimit të kritereve të përcaktuara në kuadrin normativ rregullator.<br><br>*Evidenca nr. 2 "Statuti i Universitetit të Tiranës";* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi IV.2**<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efiçente dhe efektive** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale. | Fakulteti i Drejtësisë në bashkëpunim me strukturat e saj ofron të gjithë mjediset e nevojshme për realizimin me sukses të programit mësimor të studimit "Master Profesional European Business Law", duke zbatuar metodat bashkëkohore të mësimdhënies. Ky Fakultet ka në zotërim 13 salla leksioni dhe 12 salla seminari, si dhe një sallë për zhvillimin e gjyqeve imituese të pajisur me të gjitha mjetet e nevojshme pëe simulimin e gjyqeve.<br><br>*Evidenca nr. 2 "Statuti i Universitetit të Tiranës";*<br><br>*Evidenca nr. 26 "Auditorët e Fakultetit të Drejtësisë".* |
| **Kriteri 2.** Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit. | Universiteti i Tiranës, bazuar në *nenin 37*, pika 1, të Ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", *neni 30 pika 1*, të Statutit të UT-së; me vendimin e datës 25.11.2021, Senati Akademik i UT-së, ka miratuar ngritjen e Qendrës Virtuale të Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit në Universitetin e Tiranës. Përmes kësaj qendre ofrohen trajnime të vijueshme për personelin akademik.<br><br>Shih: https://unitir.edu.al/qender-virtuale-e-trajnimit-dhe-zhvillimit-profesional/<br><br>*Evidenca nr. 25 "Krijimi i Qendrës Virtuale të Trajnimit nëUT – Vendim i Senatit UT nr.48";*<br><br>*Evidenca nr. 25 "Trajnimet dhe leksionet e zhvilluara nga Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit";*<br><br>*Evidenca nr. 27 "Informacion i detajuar mbi takimet dhe aktivitetet e zhvilluara në Fakultetin e Drejtësisë".* |
| **Kriteri 3.** Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për | Për të gjitha lëndët ofrohen materiale në formë digjitale, të disponueshme online, nëpërmjet sistemeve të informacionit të vëna në dispozicion të studentëve si dhe maeriale të pritnuara apo botuara. Studentët orientohen drejt punës kërkimore individuale dhe projekteve.<br><br>*Evidenca nr. 1 "Rregullorja e Programit të Studimit Master Profesional European Business Law";* |

| | |
|---|---|
| kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor. | *Evidenca nr. 13 "Informacion mbi programin e studimit".* |
| **Kriteri 4.** Institucioni i arsimi të lartë dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë. | Institucioni gëzon të gjitha burimet njerëzore për përmbushjen e objektivave të studimit në MP "EU Business Law"<br><br>*Evidenca nr. 13 Tabela 4 "Mbi personelin akademik të angazhuar në programin e studimit Master Profesional European Business Law".*<br><br>*Evidenca nr. 37 – CV-të e pedagogëve të angazhuar në mësimëdhënien e MP "EU Business Law"* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi IV.3**<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse. | Fakulteti i Drejtësisë disponon 28 auditore (12 salla leksioni dhe 16 salla seminari). Duke marrë në konsideratë numrin e studentëve që ndjekin programin e studimit Master EU Business Law, 55 studentë gjatë vitit 2021-2022 dhe në vijim, kushtet infrastrukturore janë optimale, parë kjo dhe në raport me numrin e përgjithshëm të studentëve që ndjekin programet e ndryshme të studimit në Fakultetin e Drejtësisë.<br><br>*Evidenca nr. 26 "Auditorët e Fakultetit të Drejtësisë";*<br><br>*Evidenca nr. 17 "Numri i studentëve të Programit të studimit Master Profesional European Business Law".* |
| **Kriteri 2.** Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të | Grupi i Vlerësuesve të Jashtëm gjatë vizitës në Institucion, konstatoi mjaftueshmërinë e hapësirës fizike në varësi të numrit të studentëve dhe natyrës së aktivitetit mësimor që zhvillohet në to, por edhe pajisjen e tyre me mjetet e |

| | |
|---|---|
| pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies. | nevojshme bazë elektronike dhe të teknologjisë së informacionit që sigurojnë kryerjen me efektivitet të llojeve të aktivitete mësimore që parashikohen sipas natyrës së moduleve. Njëkohësisht edhe hapësira në dispozicion të personelit akademik është mëse e mjaftueshme qoftë nga pikëpamja fizike ashtu dhe ajo infrastrukturore.<br>*Evidenca nr. 13 "Informacion mbi programin e studimit";*<br>*Evidenca nr. 23 "Për aparaturat dhe pajistet e FDUT";*<br>*Evidenca nr. 26 "Auditorët e Fakultetit të Drejtësisë".* |
| **Kriteri 3.** Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi. | Referuar RVB dhe vizitës në Institucion, u konstatua se mjediset e fakultetit, përfshirë klinikën e ligjit dhe një sallë për të zhvilluar gjyqe imituese, janë të pajisura me kompjuter, laptop, TV, projektorë, mikrofonë etj.<br>Këto pajisje janë pjesë integrale e procesit të mësimit në programin e studimit, duke mbështetur të gjitha metodat bashkëkohore të mësimdhënies.<br>Në bibliotekë ka mbi 10 (dhjetë) kompjutera në dispozicion të studentëve, përfshirë internet falas *wifi*, si dhe askses në bibliotekën online të mundësuar nga Ministria e Arsimit për Universitetin e Tiranës.<br>*Evidenca nr. 13 "Informacion mbi programin e studimit";*<br>*Evidenca nr. 23 "Për aparaturat dhe pajistet e FDUT";*<br>*Evidenca nr. 26 "Auditorët e Fakultetit të Drejtësisë".* |
| **Kriteri 4.** Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/eve të studimit që ofron. | Në ambientet e fakultetit u konstatua akses i lirë në internet, si dhe salla të posacme të pajisura me kompjutera, printer dhe facilitetet te tjera teknologjike që cilët ndihmojnë procesin mësimor.<br>.<br>*Evidenca nr. 23 "Për aparaturat dhe pajistet e FDUT".* |
| **Kriteri 5.** Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe /ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte | Programi Master EU Business Law nuk ofron praktikë profesionale si veprimtari më vete të planit mësimor në respektim të VKM nr.41 (të sipërcituar.) |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike | GVJ ka konstatuar nga intervistat e realizuara që praktikat mësimore teorike zhvillohen gjatë procesit mësimor në auditoret ku zhvillohet ky proces. | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | X |

| **Standardi IV.4**<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit. | Nga vizita në Institucion e GVJ, u konstatua që në dispozicion të studentëve është biblioteka e FD. Kjo bibliotekë ofron ambientet e nevojshme fizike për të përballuar një frekuentim studentë e pedagogë. Në bibliotekë ka mbi 10 (dhjetë) kompjutera në dispozicion të studentëve, përfshirë internet falas *ëifi*, si dhe askses në bibliotekën online të mundësuar nga Ministria e Arsimit për Universitetin e Tiranës.<br><br>*Evidenca nr. 22 – Rregullore e brendshme e Bibliotekës së FD* |
| **Kriteri 2.** Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore | Biblioteka gëzon kopje fizike të literaturës detyruese të programit të studimit me së paku 5 kopje për çdo lëndë. Rekomandohet që në Bibliotekë të shtohet e gjithë literature ndihmëse si dhe libra të natyrës së ngjashme me lëndët që zhvillohen në programin e studimit.<br><br>*GVJ sugjeron që në bibliotekë duhet të ketë një fond të vecantë fizik dhe elektronik të literaturës fakultative apo leksioneve të shkruara nga pedagogët e lëndës.*<br><br>*Evidenca nr. 22.1 "Lista bibliografike e librave të rinj që kanë hyrë në fondin e Bibliotekës të FD 2019-2020"* |

| | |
|---|---|
| sipas natyrës e specifikës së programit të studimit. | |
| **Kriteri 3.** Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit. | Fakulteti i Drejtësisë rezulton të ketë abonime online vjetore te hapura si JSTORE, RASH të cilat janë një mbështetje për stafin akademik dhe studentët. |
| **Kriteri 4.** Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve. | Biblioteka në dispozicion të studentëve aktualisht ka 10 kompjutera me akses në internet dhe për shfrytëzimin e burimeve online, të pajisura me programet e nevojshme kompjuterike.<br>*Evidenca nr. 22 – Rregullore e brendshme e Bibliotekës së FD* |
| **Kriteri 5.** Institucioni duhet të hartojë e të zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit. | Nga kqyrja e syllabusve të miratuara nga departamentet përkatëse për këtë program studimi rezulton si element përbërs i tyre literatura e detyrueshme dhe ajo ndihmëse. Kjo literaturë në pjesën më të madhe të saj rezulton e listuar në titujt e bibliotekës së institucionit në formatin hardcopy (libër ose print)<br>*Rekomandohet që cdo njësi baze e institucionit çdo fillim viti akademik të paraqes një listë me tituj të rinj librash për të pasuruara bibliotekën e FD në përputhje me nevojat e programeve të studimit që ofrohen nga ky institucion.* |
| **Kriteri 6.** Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj | Orari i bibliotekës së FD është i përshtatshëm dhe në përputhje me orarin e caktuar për programin e studimit MP "EU Business Law" |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| Standardi IV.5<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit. | Nga evidencat dhe vizita në Institucion, rezulton që Sekretaria Mësimore e FD si detyrim ligjor të Ligjit të arsimit të lartë Nr. 80/2015 dhe rregullores së UT, administron gjithë informacionin që lidhet me studentët: regjistrin themeltar të studentëve, regjistrin e arritjeve akademike të studentëve, të cilat arkivohen në arkivat e shtetit dhe në funksion të këtyre administron: dosjet e regjistrimit të studentëve, procesverbalet e provimeve dhe detyrimeve, dosjet e transferimit të studentëve, statistika të frekuentimit të studentëve, të studentëve që çregjistrohen, dosjet e diplomimit etj. Të gjitha këto arkivohen në arkivin e sekretarisë mësimore dhe shërbejnë si bazë për dhënien e informacioneve zyrtare nga sekretaria.<br>Është në proces ndërtimi i sistemit te ri elektronik për administrimin e të dhënave për studentët dhe lidhjen e tij me sistemin qeveritar *e-albania* |
| **Kriteri 2.** Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. | Nga vizita në Institucion, rezulton që Dega e Burimeve Njerëzore, është sektori që administron gjithë informacionin e duhur për personelin akademik (efektiv dhe me kontratë), ndihmës akademik dhe administrativ, informacion ky që konsiston nga i gjithë dokumentacioni lidhur me arsimimin, përparimin akademik, procedurat e punësimit dhe kontratat e punës së secilit. Këto të dhëna përditësohen vazhdimisht në varësi të përparimit të secilit, sipas aktivitetit përkatës. Gjatë vizitës në institucion, gjatë shqyrtimit rastësor të disa prej dokumentacionit të stafit akademik PAE dhe atij PAK, u vu re së në disa prej tyre kishte mangësi informacioni, apo informacion jo të azhornuar. |
| **Kriteri 3.** Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit. | Çdo lloj aktiviteti dhe informacioni që nevojitet në kuadër të Programit të Studimit, qarkullohet në kohë reale jo vetëm përmes publikimit në faqen zyrtare online të institucionit, por edhe në rrugë elektronike nëpër adresat e deklaruara paraprakisht të stafit akademik dhe studentëve, ashtu si dhe publikohet në rrjetet sociale që administrohen nga ana e Fakultetit me qëllim informimin e studentëve, si dhe përmes Zyrës së Informacionit. Në këtë mënyrë, njësia kryesore ka |

| | |
|---|---|
| | një sistem që garanton askses të plotë dhe të menjëhershëm në informacion. |
| **Kriteri 4.** Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve. | Komunikimi elektronik zhvillohet jo vetëm nëpërmjet postës zyrtare elektronike dhe faqes së Ëeb-it të FD por dhe nëpërmjet platformës Microsoft Teams e cila lejon jo vetëm diskutimin dhe komunikimin interaktiv, por edhe publikimin e materialeve për studentët e programit. Është një mënyrë komunikimi që gjithashtu lejon monitorimin në kohë reale të këtyre publikimeve. Nga ana tjetër, sistemi i menaxhimit i ngritur për qëllime komunikimi, përmes rrugës elektronike, apo publikimeve në faqen zyrtare dhe/apo rrjetet sociale apo përmes Zyrës së Informacionit, gjithashtu lejon monitorimin e aktivitetit akademik dhe administrativ, duke lejuar mbledhjen në kohë reale edhe të çdo lloj problematike të raportuar. |
| **Kriteri 5.** Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët. | Sistemi i menaxhimit siguron adresa personale uniforme me domain të institucionit dhe llogari me akses elektronik personal. Gjithashtu, në dispozicion është platforma TEAMS, faqet zyrtare të UT dhe FD ku informacioni është i drejtpërdrejte në kohë reale si për studentët që duan të informohen ashtu dhe për personelin akademik dhe administrativ që do të informojë.<br><br>*<u>Rekomandohet</u> rivënia në funksion e sistemit të menaxhimit dhe pasurimi i këtij sistemi dhe me zëra të tjerë pervëç rezultatetve të provimeve.* |
| **Kriteri 6.** Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe | Të gjitha informacionet e nevojshme që lidhen me programet e studimit, personelin akademik si dhe aktivitete të ndryshme merren nëpërmjet faqes elektronike të UT, faqes elektronike të FD. Informacionet e publikuara në faqen e Ëeb-it të FD janë kryesisht në gjuhën shqipe.<br><br>*Evidenca https://fdut.edu.al/* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

**Standardi IV.6**

| Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve. | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi. | Në përputhje me Statutin e institucionit, autoriteti vendimarrës për miratimin e buxhetit të një viti kalendarik për Universitetin e Tiranës është Bordi Administrimit, mbështetur në propozimin për buxhetin vjetor të Fakultetit të Drejtësisë dhe njësive të tjera kryesore përbërse të UT, duke mbajtur në konsideratë dhe analizën e realizimit të buxhetit për vitin pararendës kalendarik.<br><br>Vendimi reflekton përmbushjen e nevojave dhe kërkesave të Fakultetit të Drejtësisë, përmes: Detajimit të kuotave të Buxhetit për një vit kalendarik; Projekteve të investimeve me financim të brendshëm (të ardhura) për vit kalendarik; etj.<br><br>GVJ konstaton mundësinë e nevojshme financiare të institucionit për të përballuar mbarëvajtjen e programit të studimit në vijim.<br><br>*Evidenca nr. 2 "Statuti i Universitetit të Tiranës";*<br><br>*Evidenca nr. 35 Vendimi nr. 12, datë 7.4.2022, i Bordit të Administrimit, Universiteti i Tiranës "Mbi miratimin e Buxhetit të vitit 2022 të UT-së";*<br><br>*Evidencë nr. 36"Analiza e Realizimit të Buxhetit për Vitin 2021 dhe detajimi i planit për vitin 2022, e Administratorit të Fakultetit të Drejtësisë, drejtuar Dekanit të Fakultetit të Drejtësisë".* |
| **Kriteri 2.** Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burime njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse ap të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidh | Nga aktet e shqyrtuara rezulton se në buxhetin vjetor të parashikuar dhe miratuar nga Bordi Administrimit të UT, parashikohen burime financiare të cilat mbulojnë në tërësi nevojat e Fakultetit të Drejtësisë. Zërat në buxhet parashikojnë:<br><br>-Projekteve të investimeve me financim të brendshëm (të ardhura) për vit kalendarik, veçanërisht për: Blerje paisje elektronike, Blerje pajisje mobilimesh për auditorë; Fondet për përballimin e pagave të punonjësve të planifikuar për vit kalendarik;fonde për publikime profesionale, abonime në gazeta periodike, revista, publikime profesionale, etj. |

| | |
|---|---|
| në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra tjerë, sipas natyrës specifike të tij. | *Evidenca nr. 35 Vendimi nr. 12, datë 7.4.2022, i Bordit të Administrimit, Universiteti i Tiranës "Mbi miratimin e Buxhetit të vitit 2022 të UT-së";*<br><br>*Evidencë nr.36 "Analiza e Realizimit të Buxhetit për Vitin 2021 dhe detajimi i planit për vitin 2022, e Administratorit të Fakultetit të Drejtësisë, drejtuar Dekanit të Fakultetit të Drejtësisë".* |
| **Kriteri 3.** Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare. | Si rregull Fakulteti i Drejtësisë i nënshtrohet auditimit periodik të kryer nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm të Universitetit të Tiranës.<br><br>Megjithatë GVJ-së, nuk i është paraqitur në dokumentacionin e dorëzuar dhe as në takim raportet e auditit të Fakultetit të Drejtësisë. |
| **Kriteri 4.** Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij. | *Kjo e dhënë nuk rezulton në dokumentacionin e dorëzuar nga institucioni* |
| **Kriteri 5.** Institucioni i arsimit të lartë duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të | Sistemi i menaxhimit dhe kontrollit në Fakultetin e Drejtësisë i nënshtrohet jo vetëm mënyra të kontrollit të brendshëm, por dhe auditimit të jashtëm, pikërisht për të garantuar qëndrueshmërinë financiare. Analiza e zbatimit të buxhetit për një vit kalendarik, kushtëzon sipas legjislacionit në fuqi edhe përgatitjen e buxhetit për vitin pasardhës, ndaj planifikimi i shpenzimeve buxhetore bëhet në përputhje strikte me nevojat e Fakultetit, specifikisht programeve të ndryshme mësimore. Rishikimi buxhetor për përshtatjen e fondeve me nevoja që mund të lindin, bëhet sipas kuadrit ligjor në fuqi. Diversifikimi eventual i financimit të programeve të studimit, lidhet gjithashtu edhe me |

| | |
|---|---|
| domosdoshme në të ardhmen | përcaktimin e nivelit të tarifave të regjistrimit dhe të shkollimit për programin e studimit të ciklit të dytë Master Profesional në "Të Drejtë Biznesi të BE-së"/"EU Business Laë", për një vit akademik.<br><br>*Evidencë nr. 15 "Vendim nr. 35, datë 21.10.2020 i Senatit Akademik, Universiteti i Tiranës "Për miratimin paraprak të tarifës së regjistrimit dhe shkollimit për programin e studimit të ciklit të dytë "Master Profesional European Business Laë" Fakulteti i Drejtësisë, për vitin akademik 2020-2021" (nr. 2901/1 prot., datë 21.10.2020).* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

| **Standardi V.1**<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore. | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar nga vizita në Fakutetin e Drejtësisë, GVJ konstaton se institucioni zbaton politika për programin e studimit Master Profesional "EU Business Laë"në përputhje me aktet ligjore në fuqi dhe të përcaktuara në Statutin e UT si dhe në rregulloren e programit të studimit Master professional "EU Business Laë". Institucioni kujdeset që nga regjistrimi i studentëve dhe pajisja e tyre me numër matrikullimi, krijimi i dosjes së studentit dhe deri tek diplomimi dhe suplementi i diplomës.<br><br>*Evidenca nr. 1 "Rregullore Programi i Studimit të Masterit Profesional "European Business Laë";*<br><br>*Evidenca nr. 2 "Statuti i Universitetit të Tiranës";* |

| | |
|---|---|
| | *Evidenca nr. 4"Strategjia e Zhvillimit të Universitetit të Tiranës 2018-2023";*<br><br>*Evidenca nr.6 "Strategjia institucionale për mësimdhënien – UT 2022-2027";*<br><br>*Evidenca nr.7 "VKM-të Për hapjen e Masterit;*<br><br>*Evidenca nr. 10 "Rregullorja e Brendshme për organizimin e programit rajonal të masterit për të drejtën e biznesit të BE-së";*<br><br>*Evidenca nr.14.1 "Mbi strukturën akademike në programin e studimit Master Profesional "European Business Laë".* |
| **Kriteri 2.** Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit. | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Fakultetin e Drejtësisë, GVJ konstaton se Politikat dhe procedurat që kanë të bëjnë me përparimin e studentëve, frekuentimin e tyre, përfaqësimin e tyre në organet drejtuese etj janë të rregulluara nëpërmjet dokumenteve zyrtare të UT, Statutit të UT, rregullores së UT, dhe rregullores së programit të studimit. Në to janë të pasqyruara qartë të drejtat dhe detyrat e studentëve, të cilat garantojnë barazinë ndërmjet tyre.<br>*Evidenca nr. 2 "Statuti i Universitetit të Tiranës";* |
| **Kriteri 3.** Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë ndjekjes së programit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku. | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në Fakultetin e Drejtësisë, GVJ konfirmon se në zbation të politikave dhe procedurave, institucioni ka përdorur një sërë mjetesh dhe metodash bashkëkohore për publikimin e kritereve dhe procedurave të aplikimit, pranimit dhe regjistrimit të studentëve, procesit të vlerësimit të dijeve si dhe të diplomimit të studentëve të programit të studimit Master Profesional "European Business Laë". Kriteret e pranimit për aplikantët shpallen publikisht nga FDUT në ambientet e fakultetit dhe në faqen zyrtare të FDUT përpara fillimit të aplikimeve.<br><br>*Evidenca Nr.1 Rregullore e Programit të studimit "Master Profesional European Business Laë" ;*<br><br>*Evidenca Nr. 2 "Statuti i UT";*<br><br>*Evidenca Nr.29 "Vendim nr. 10, datë 28.09.2022 i Dekanatit të FDUT https://fdut.edu.al/2022/09/28/vendim-nr-10-date-28-09-2022/.* |
| **Kriteri 4.** Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar nga vizita në Fakuktetin e Drejtësisë, në fillim të çdo viti akademik Fakulteti vë në |

| | |
|---|---|
| kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e dytë të studimeve. | dispozicion të studentëve broshura dhe ditë informimi me aktet ligjore dhe nënligjore, statut dhe rregullore të njësisë.<br>*Evidenca Nr.1 Rregullore e Programit të studimit "Master Profesional European Business Laë" ;*<br>*Evidenca Nr. 2 "Statuti i UT".*<br>*Evidenca Nr.3 "Rregullore e UT" ;*<br>*Evidenca Nr. 30 "Guida e Fakultetit".* |
| **Kriteri 5.** Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit | GVJ konstaton se FD-UT vë në dispozicion të publikut broshura informuese për t'i informuar dhe njohur ata me programin e studimit, organzimin e institucionit, të drejtat dhe detyrat e studentit, jetën studentore, etj. Ky informacion mund të aksesohet edhe në faqen online të fakultetit. Çdo departament përcakton kuotat e pranimit, kriteret e pranimit dhe të përzgjedhjes së aplikantëve fitues jo më vonë se data 10 Dhjetor e vitit paraardhës kalendarik, për të gjitha programet e studimit që ofron.<br>*Evidenca Nr. 2 "Statuti i UT";*<br>*Evidenca Nr.29 "Vendim nr. 10, datë 28.09.2022 i Dekanatit të FDUT*<br>*https://fdut.edu.al/2022/09/28/vendim-nr-10-date-28-09-2022/ ;*<br>*Evidenca Nr. 30 "Guida e Fakultetit".* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi V.2**<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në FD, GVJ konstaton se për programin e studimit "Master Profesional European Business Laë" janë vënë në dispozicion të studentëve informacion të plotë në lidhje me kriteret dhe procedurat e avancimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin, detyrimeve akademike, etj, përmes organizimit të javës orientuese ku mbahen takime dhe |

| | |
|---|---|
| | leksione për shpjegimin e sistemit të studimeve, të rregulloreve dhe të procedurave administrative për studentët e rinj. GVJ konfirmom se ky informacion mund të aksesohet nga studentët edhe online në faqen e fakultetit.<br><br>*Evidenca Nr.1 Rregullore e Programit të studimit "Master Profesional European Business Laë" ;*<br><br>*Evidenca Nr. 2 "Statuti i UT";*<br><br>*Evidenca Nr.3 "Rregullore e UT";*<br><br>*Evidenca Nr. 30 "Guida e Fakultetit";*<br><br>*https://fdut.edu.al/* |
| **Kriteri 2.** Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacioni të siguruar gjatë vizitave, GVJ konfirmon se në zbatim të politikave dhe procedurave, Institucioni ka përdorur një sërë mjetesh dhe metodash bashkëkohore për publikimin e kritereve dhe procedurave të aplikimit, pranimit dhe regjistrimit të studentëve, procesit të vlerësimit të dijeve si dhe diplomimit të studentëve.<br><br>Kriteret dhe procedurat e aplikimit janë publikuar përpara fillimit të vitit akademik në faqen zyrtare të institucionit, në fushata informuese, broshura informuese si dhe gjatë procesit të informimit dhe këshillimit në zyrat përkatëse në institucion në përputhje me përcaktimet në Statutin dhe Rregulloren e UT-së.<br><br>*Evidenca Nr.1 Rregullore e Programit të studimit "Master Profesional European Business Laë" ;*<br><br>*Evidenca Nr. 2 "Statuti i UT";*<br><br>*Evidenca Nr.3 "Rregullore e UT";*<br><br>*Evidenca Nr. 30 "Guida e Fakultetit".* |
| **Kriteri 3.** Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit. | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB, GVJ konstaton se FD në zbatim të përcaktimeve në Rregullore e Programit të studimit "Master Profesional European Business Laë" ka informuar studentët në lidhje me kriteret dhe procedurat e vlerësimit ë përgatitjes akademike të studentit. Ky mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm dhe nota përfundimtare është rezultante e kombinimit të detyrave të kursit jo më pak se 50% të vlerësimit dhe provimit. GVJ konstaton se programi i çdo lënde përcakton qartë nëse do të organizohet edhe provimi përfundimtar krahas atij të ndërmjetëm. Shkalla e përvetësimit të dijeve realizohet me shkrim dhe/ose me gojë bëhet me pikë nga 0-100 pikë dhe |

| | |
|---|---|
| | rezultati përfundimtar konvertohet në notë nga 4 (katër) në 10 (dhjetë). Parashikohet procedurë ankimimi në rast se studenti ka ankesë për pikët që ka marrë në një nga komponentët e vlerësimit siaps parashikimeve në aktet e brendshme të institucionit.<br>*Evidenca Nr.1 Rregullore e Programit të studimit "Master Profesional European Business Laë" ;*<br>*Evidenca Nr. 2 "Statuti i UT";*<br>*Evidenca Nr.3 "Rregullore e UT";*<br>*Evidenca nr. 12.1 – Plani mësimor i programit të ciklit të dytë të studimit: Master Profesional European Business Laë, për vitin akademik 2020 – 2021 ;*<br>*Evidenca nr. 13 – Informacion mbi programin e studimit "Master Profesional European Business Laë" ;*<br>*Evidenca Nr. 30 "Guida e Fakultetit".* |
| **Kriteri 4.** Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit. | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion, GVJ konstaton se institucioni në zbatim të Rregullores së Programit të studimit "Master Profesional European Business Laë" informon studentët në lidhje me procedurën e punimit të diplomës dhe diplomimit në këtë program studimi, i cili organizohet si punim diplome i vlerësuar me notë.<br>*Evidenca Nr.1 Rregullore e Programit të studimit "Master Profesional European Business Laë" ;*<br>*Evidenca Nr. 2 "Statuti i UT";*<br>*Evidenca Nr.3 "Rregullore e UT";*<br>*Evidenca nr. 21 – Udhëzues i Fakultetit të Drejtësisë, UT, "Mbi strukturën dhe rregullat e shkrimit të tezës së Masterit"* |
| **Kriteri 5.** Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit | Institucioni, në rang universiteti, por edhe njësie kryesore dhe në ato bazë, publikon udhëzues të posaçëm, si broshura dhe fletëpalosje mbi kriteret e pranimit dhe informacione në lidhje me programet e studimit të ofruara nga Universiteti i Tiranës, dhe në veçanti ato të ofruara në Fakultetin e Drejtësisë. GVJ konstaton se përpara fillimit të cdo viti akademik institucioni organizon ditët e informimit dhe fushata të vazhdueshme informuese për të interesuarit dhe për për studentët e Fakultetit mbi programet e studimit që ofron.<br>*Evidenca Nr.1 Rregullore e Programit të studimit "Master Profesional European Business Laë" ;*<br>*Evidenca Nr. 2 "Statuti i UT";* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *Evidenca Nr.3 "Rregullore e UT";*<br>*Evidenca Nr. 30 "Guida e Fakultetit".* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi V.3**<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.<br><br>**Kriteri 2.** Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese. | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion, GVJ konstaton se institucioni ka vënë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve si dhe për lëndër, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese. Në javën e orientimit, krahas prezantimit të programit të studimit nga decani dhe përgjegjësi i departamentit, realizohet prezantimi i objektivave dhe njohurive e aftësive që fitohen nga cdo lëndë. Ky informacion u bëhet I ditur studentëve në klasë nga pedagogu dhe publikohet në formën e një broshure nga Fakulteti i Drejtësisë dhe në faqen zyrtare të institucionit.<br><br>*Evidenca Nr.1 Rregullore e Programit të studimit "Master Profesional European Business Laë" ;*<br>*Evidenca Nr. 2 "Statuti i UT";*<br>*Evidenca Nr.3 "Rregullore e UT";*<br>*Evidenca nr. 12.1 – Plani mësimor i programit të ciklit të dytë të studimit "Master Profesional European Business Laë", për vitin akademik 2020 – 2021;*<br>*Evidenca nr. 13 – Informacion mbi programin e studimit "Master Profesional European Business Laë"*<br>*Evidenca Nr. 30 "Guida e Fakultetit".* |
| **Kriteri 3.** Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale | Referuar RVB-së, Fakulteti i Drejtësisë, si njësia kryesore për këtë program studimi, publikon të gjitha njoftimet për punësim dhe internshipe në faqen zyrtare të tij. Kjo mundëson akses të gjerë në informacion të studentëve |

| | |
|---|---|
| për orientimin drejt dhe në tregun e punës. | *Evidenca nr. 24 – Njoftime për studentët e programit të studimit të ciklit të dytë "Master Profesional European Business Laë";*<br><br>*Faqja ëeb zyrtare të Fakultetit të Drejtësisë, UT :* *https://fdut.edu.al/* . |
| **Kriteri 4.** Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. | GVJ bazuar në informacionin e siguruar gjatë vizitave në institucion, konstaton se institucioni informon studentët nëpërmjet burimeve të ndryshme mbi organizimin dhe zhvillimin e procesit mësimor, logjistikën dhe infrastrukturën mbështetëse si dhe shërbimet e ofruara nga institucioni në funksion të realizimit të programit të studimit. Që në javën e parë të orientimit studentët njihen me kalendarin akademk, orarin mësimor, ambientet, mjetet dhe shërbimet në funksion të PS.<br><br>Informacioni gjendet i afishuar në këndet e njoftimeve pranë ambienteve të Fakultetit të Drejtësisë si dhe në faqen zyrtare të tij. GVJ konstaton se faqja Ëeb e FD ka informacion të përditësuar lidhur me orarin e zhvillimit të procesit mësimor, data provimesh, struktura akademike, plane mësimore, formularë aplikimi etj.<br><br>*Faqja ëeb zyrtare të Fakultetit të Drejtësisë, UT :* *https://fdut.edu.al/* .<br><br>*Evidenca Nr. 30 "Guida e Fakultetit".* |
| **Kriteri 5.** Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë | |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi V.4**<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë*, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit. | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB, GVJ konstaton se në sekretarinë mësimore të institucionit mbahen dhe regjistrohen të dhëna vjetore për numrin e studentëve nga regjistrimi deri ne diplomimin e tyre në programin e studimit Master Profesional "European Business Law". |

| | |
|---|---|
| | *Evidenca nr. 17 – Rregjistrimet e studentëve në fillim të vitit akademik – me kohë të plotë. Të dhënat indentifikuese 2021–2022 – Master Profesional .* |
| **Kriteri 2.** Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve. | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion, GVJ konstaton se sic u cilësua dhe në kriterin e parë, institucioni disponon të dhëna vjetore për studentët e regjistruar, transferuar dhe diplomuar.<br><br>Mbështetur në vizitën në institucion rezulton se numri i studentëve për tre vitet akademike është:<br><br>2020-2021 81 studentë;<br>2021-2022 54 studentë;<br>2022-2023 40 studentë;<br><br>*Evidenca nr. 17 – Rregjistrimet e studentëve në fillim të vitit akademik – me kohë të plotë. Të dhënat indentifikuese 2021–2022 – Master Profesional.* |
| **Kriteri 3.** Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre. | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave, GVJ konstaton se Fakulteti i Drejtësisë disponon të dhëna në sekretarinë mësimore për studentët e Programit të studimit "Master Profesional European Business Laë" nga pranimi deri në përfundim të studimeve. Këto të dhëna statistikore përdoren nga fakulteti për analiza të ndryshme.<br><br>*Evidenca nr. 17 – Rregjistrimet e studentëve në fillim të vitit akademik – me kohë të plotë. Të dhënat indentifikuese 2021–2022 – Master Profesional.* |
| **Kriteri 4.** Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar. | GVJ konstaton se sic është cilësuar edhe më lart në raport, për menaxhimin e të dhënave sekretaria mësimore përdor të dhënat statistikore të studentëve si dhe akseson dhe realizon verifikimin e tyre. Institucioni është angazhuar në marrjen e masave teknike për të mbrojtur të dhënat personale në zbatim të Urdhrit Nr.12, datë 08.06.2015: Mbi Miratimin e Rregullores "Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në Universitetin e Tiranës".<br><br>*Evidenca nr. 32 - URDHËR Nr.12 datë 08.6.2015 i Rektoratit të UT-së : Mbi Miratimin e Rregullores "Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në Universitetin e Tiranës"* |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 5.** Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë të punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve | Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga GVB konstatohet se Pranë Bordit të Administrimit funksionon Drejtoria e Auditit të Brendshëm, e cila e ushtron veprimtarinë e saj kontrolluese dhe monitoruese në përputhje me Ligjin nr. 114/2015 dhe Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 40, datë 08.05.2017.<br><br>*Evidenca nr. 2 – Statuti i Universitetit të Tiranës ;*<br><br>*Evidenca nr. 3 – Rregullorja e Universitetit të Tiranës ;*<br><br>*Evidenca nr. 4 – Strategjia e Zhvillimit të Universitetit të Tiranës 2018 – 2023;*<br><br>*Evidenca nr. 6 – Strategjia institucionale për mësimdhënien Universiteti i Tiranës 2022 – 2027* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi V.5**<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve. | Në zbatim të Ligjit të arsimit të larte dhe Rregullores dhe Statutit të UT, studentët marrin pjesë në disa organe kolegjiale si: Senati Akademik, Komisioni i mbarëvajtjes së veprimtarisë dhe marrëdhënieve me studentët, Komisioni i përhershëm për sigurimin e standardeve të cilësisë, Komisioni i përhershëm i kurrikulës, Këshilli i etikës. Gjithashtu studentët marrin pjesë në grupet e vlerësimit të brendshëm për vlerësimin e programeve të studimit dhe vlerësimin institucional. Studentët janë dhe pjesë e vlerësimit të mësimdhënies dhe personelit akademik, nëpërmjet pyetësorëve që organizohen periodikisht me ta.<br><br>*Evidenca nr. 2 – Statuti i Universitetit të Tiranës ;*<br><br>*Evidenca nr. 3 – Rregullorja e Universitetit të Tiranës* |
| **Kriteri 2.** Institucioni i arsimit të lartë duhet të | GVJ konstaton se bazuar në informacionet e marra gjatë vizitave ne institucion dhe dokumentacionit të vënë në |

| | |
|---|---|
| garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme. | dispozicion, bazuar në Statutin e UT-së (*Neni 129,132,141*), studentët kanë përfaqësuesit e tyre në Senatin Akademik, Këshillin e Etikës, Komisionet e Përhershme dhe Këshillat e Studentëve.<br>*Evidenca nr. 2 – Statuti i Universitetit të Tiranës ;*<br>*Evidenca nr. 3 – Rregullorja e Universitetit të Tiranës ;* |
| **Kriteri 3.** Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, duke përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme. | Bazuar në dokumentacioni e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacioni i marrë në institucion, GVJ konstaton se gjatë hartimit të planit mësimor të këtij programi është bërë një ndarje korrekte të lëndëve në semestra dhe kredite duke mbajtur në fokus ngarkesën akademike të studentëve në këtë program studimi<br>*Evidenca Nr.1 Rregullore e Programit të studimit "Master Profesional European Business Laë" ;*<br>*Evidenca nr. 12.1 – Plani mësimor i programit të ciklit të dytë të studimit "Master Profesional European Business Laë", për vitin akademik 2020 – 2021;*<br>*Evidenca nr. 13 – Informacion mbi programin e studimit "Master Profesional European Business Laë"* |
| **Kriteri 4.** Institucioni i arsimit të lartë garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to. | Bazuar në dokumentacioni e vënë në dispozicion dhe intervistat në institucion, GVJ konstaton se në kuadër të përmirësimit të programit të studimit UT inkurajon dhe përfshin në diskutime edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet dhe opinionet e tyre diskutohen në nivel Departamenti dhe Fakulteti dhe nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit gjejnë reflektim në programet e studimit. Gjatë këtyre takimeve studentët shprehin mendimet, problematikat, vlerësimet apo rekomandimet e tyre lidhur me programet e studimit.<br>*Evidenca nr. 2 – Statuti i Universitetit të Tiranës ;*<br>*Evidenca nr. 3 – Rregullorja e Universitetit të Tiranës ;*<br>*Evidenca nr 27 "Informacion i detajuar mbi takimet dhe aktivitetet e zhvilluara nga Fakulteti i Drejtësisë".* |
| **Kriteri 5.** Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së | GVJ konstaton se studentët shprehin opinionin e tyre për punën e personelit akademik të FDUT-së, përfshi mendimin mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, nëpërmjet vlerësimeve që |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës. | organizohen nga Njësitë e Sigurimit të Cilësisë në përputhje me Statutin dhe Rregulloren. Studentët u mundësohet e drejta për të përmirësuar notën, si dhe për të kërkuar rivlerësim. *Evidenca nr. 1 – Rregullore e Programit të studimit "Master Profesional European Business Laë" ;* *Evidenca nr. 2 – Statuti i Universitetit të Tiranës, neni 125.5, 141.3;* *Evidenca nr. 3 – Rregullorja e Universitetit të Tiranës ;* *Evidencë nr. 39 – Model Pyetësori i Studentit.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi V.6** **Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve. | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në institucion, GVJ konstaton se institucioni në përputhje me aktet rregullatore ka ngritur Zyrën e Karrierës në Fakultet, e cila informon studentët mbi programin e studimit, përmbajtjen dhe organizimin e tij, kohëzgjatjen e studimeve në këtë program dhe afatin e përfundimit, mundësitë e punësimit etj. Kjo zyrë mban marrëdhënie të vazhdueshme me studentët dhe këshillat studentor, drejton procesin e rekrutimit, mban komunikim me partnerët e tregut të punës dhe ofron asistencë në orientimin dhe zhvillimin e karrierës universitare e profesionale të studentëve. *Evidenca nr. 2 – Statuti i Universitetit të Tiranës ;* *Evidenca nr. 3 – Rregullorja e Universitetit të Tiranës ;* *Evidenca nr. 4 – Strategjia e Zhvillimit të Universitetit të Tiranës 2018 – 2023;* *Evidenca nr. 6 – Strategjia institucionale për mësimdhënien Universiteti i Tiranës 2022 – 2027;* https://fdut.edu.al/ |
| **Kriteri 2.** Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. . | |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 3.** Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës. | GVJ konstaton se Fakulteti i Drejtësisë ka ofruar ofruar shërbimin e këshillimit të karrierës duke mirëpritur studentët në mënyrë të vazhduar, duke i orientuar qoftë në drejtim të përfundimit me suksese të karrierës së tyre universitare, qoftë në orientimin e këshillimin e karrierës profesionale. Mund të përmendim angazhimin e plotë të kësaj zyre për përfshirjen e studentëve në: ëorkshope, trajnime, open day, panaire pune, orë të hapura, krijimi i një CV-je, si të shkruajmë një letër motivimi, pjesëmarrje në konferenca studentore, mundësi të ndryshme studimi në të gjitha nivelet jashtë vendit, programe shkëmbimi Ersamus+, shkolla verore, internshipe, etj.<br><br>*Evidenca nr. 4 – Strategjia e Zhvillimit të Universitetit të Tiranës 2018 – 2023;*<br><br>*Evidenca nr. 6 – Strategjia institucionale për mësimdhënien Universiteti i Tiranës 2022 – 2027;*<br><br>*Evidenca nr. 13 – Informacion mbi programin e studimit "Master Profesional European Business Laë";*<br><br>*Evidenca nr. 25 – Vendim nr.48, datë 25.11.2021, nr.4103 Prot. i Senatit Akademik UT "Për miratimin e ngritjes së Qendrës Virtuale të Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit në Universitetin e Tiranës ;* |
| **Kriteri 4.** Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve, organeve dhe autoriteteve drejtuese përkatëse | Bazuar në dokumentacioni e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se Zyra e Këshillimit të Karrierës ka në fokus të saj nxitjen e bashkëpunimit me studentët dhe synon të realizojë lidhjen mes studimeve akademike dhe mundësive të punësimit për studentët e diplomuar në Fakultetin e Drejtësisë UT.<br><br>*Evidenca nr. 2 – Statuti i Universitetit të Tiranës ;*<br><br>*Evidenca nr. 3 – Rregullorja e Universitetit të Tiranës;*<br><br>*Evidenca nr. 4 – Strategjia e Zhvillimit të Universitetit të Tiranës 2018 – 2023*<br><br>*Evidenca nr. 25 – Vendim nr.48, datë 25.11.2021, nr.4103 Prot. i Senatit Akademik UT "Për miratimin e ngritjes së Qendrës Virtuale të Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit në Universitetin e Tiranës .* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [redacted] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |





| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER PROFESIONAL

| Standardi VI.1<br><br>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë. | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale. | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në institucion, GVJ konstaton se janë hartuar dhe zbatohen politika, struktura dhe procedura në përputhje me aktet ligjore në fuqi dhe ato rregullatore të institucionit. Një ndër funksionet e Statutit të Universitetit të Tiranës është të garantojë sigurimin e brendshëm të cilësisë dhe ngritja e njësisë së brendshmë të sigurimit të cilësisë. GVJ konstaton se sigurimi i brendshëm i cilësisë realizohet nga vetë UT-ja nëpërmjet strukturave hierarkike organizative të brendshme, të cilat planifikojnë, organizojnë dhe garantojnë zbatimin e politikave, strategjive dhe procedurave për përmbushjen e vizionit të tij.<br><br>*Evidenca nr. 1 – Rregullore e Programit të studimit "Master Profesional European Business Laë" ;*<br><br>*Evidenca nr. 2 – Statuti i Universitetit të Tiranës ;*<br><br>*Evidenca nr. 3 – Rregullorja e Universitetit të Tiranës ;*<br><br>*Evidenca nr. 4 – Strategjia e Zhvillimit të Universitetit të Tiranës 2018 – 2023;*<br><br>*Evidenca nr. 6 – Strategjia institucionale për mësimdhënien Universiteti i Tiranës 2022 – 2027* |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 2.** Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm. | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në institucion, UT bazuar në Vendimin e Senatit Akademik të UT-së Nr.10, datë 11.04.2019 ka krijuar Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë, i cili është krijuar dhe funksionon në përputhje me Ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë. KPSSC monitoron cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies, organizon dhe koordinon aktivitetetet gjatë procesit të vlerësimit të brendshëm, harton dhe publikon raporte periodike të vlerësimit të brendshëm etj. Kjo strukturë përbëhet nga 11 anëtarë, 8 anëtarë personel akademik dhe 3 anëtarë studentë, ku FSHN përfaqësohet me 1 anëtar personel akademik. UT ka krijuar Sektorin e Sigurimit të Cilësisë si strukturën ndihmëse akademike që mbështet veprimtarinë e KPSSC dhe NJSBC në njësitë kryesore.<br>*Evidenca nr. 2 – Statuti i Universitetit të Tiranës ;*<br>*Evidenca nr. 3 – Rregullorja e Universitetit të Tiranës ;*<br>*Evidenca nr. 4 – Strategjia e Zhvillimit të Universitetit të Tiranës 2018 – 2023;*<br>*Evidenca nr. 6 – Strategjia institucionale për mësimdhënien Universiteti i Tiranës 2022 – 2027;*<br>*Evidencë nr. 40 - "Vendim nr.43, datë 07/12/2020 "Për emërimin e anëtarëve të KPSSC".*<br>*Evidenca nr. 34 - Vendim Rektorati, nr.3, datë 24.01.2022, për miratimin në parim të Rregullores "Mbi vlerësimin e performancës në punë të personelit ndihmës akademik dhe administrativ në UT";*<br>*Evidenca nr. 27 – Informacion i detajuar mbi takimet dhe aktivitetet e zhvilluara nga Fakulteti i Drejtësisë, UT ;* |
| **Kriteri 3.** Institucioni i arsimit të lartë përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në institucion, GVJ konstaton se Njësia funksionla e Sigurimit të Cilësisë, në funksion të dëtyrës për garantimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë bazuar në aktet rregullatore të UT, përdor instrumentat e duhura të verifikimit, dokumentimit, anketimit në funksion të promovimit dhe përmirësimit të cilësisë. Universiteti i Tiranës ka zhvilluar procesin e vlerësimit institucional në kuadër të akreditimit periodik. Ky vlerësim u finalizua me Vendimin e Bordit të Akreditimit Nr. 4 datë 27.01.2023, që e ka akredituar institucionin për 6 vite akademike. |

| | |
|---|---|
| promovojnë e përmirësojnë cilësinë. | *Evidenca nr. 2 – Statuti i Universitetit të Tiranës ;*<br>*Evidenca nr. 3 – Rregullorja e Universitetit të Tiranës ;*<br>*Evidenca nr. 4 – Strategjia e Zhvillimit të Universitetit të Tiranës 2018 – 2023;*<br>*Evidenca nr. 6 – Strategjia institucionale për mësimdhënien Universiteti i Tiranës 2022 – 2027;* |
| **Kriteri 4.** Institucioni i arsimit të lartë ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit. | GVJ konstaton se UT ka një poltikë të qartë ne kuadër të sigurimit të brendshëm të cilësisë. Në dokumentet zyrtare siç është Statuti i UT-së parashikohen qartë procedurat e posaçme për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve që ofrohen. Në rregulloren e sigurimit të cilësisë janë përcaktuar procedurat, afatet, instrumentet dhe burimet për sigurimin e brendshëm të cilësisë. NJSBC, nëpërmjet vlerësimit të brendshëm të cilësisë, realizon qëllimin kryesor të saj, përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë dhe të kulturës së cilësisë brenda institucionit. Gjatë vlerësimit periodik të cilëisë, NJSBC mbikëqyr, analizon dhe rekomandon rregullimet e nevojshme në drejtimet kryesore, sipas përcaktimeve të Standardeve të cilësisë në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë.<br><br>*Evidenca nr. 2 – Statuti i Universitetit të Tiranës ;*<br>*Evidenca nr. 3 – Rregullorja e Universitetit të Tiranës ;*<br>*Evidenca nr. 4 – Strategjia e Zhvillimit të Universitetit të Tiranës 2018 – 2023;*<br>*Evidenca nr. 6 – Strategjia institucionale për mësimdhënien Universiteti i Tiranës 2022 – 2027;*<br>*Evidenca nr. 34 - Vendim Rektorati, nr.3, datë 24.01.2022, për miratimin në parim të Rregullores "Mbi vlerësimin e performancës në punë të personelit ndihmës akademik dhe administrativ në UT";*<br>*Evidenca nr. 27 – Informacion i detajuar mbi takimet dhe aktivitetet e zhvilluara nga Fakulteti i Drejtësisë, UT ;*<br>*Evidencë nr. 40 - "Vendim nr.43, datë 07/12/2020 "Për emërimin e anëtarëve të KPSSC".* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi VI.2** |
|---|

| **Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të dytë.<br><br>**Kriteri 2.** Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të dytë. | Për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen dhe rishikimin e programeve të studimit, rezulton që UT ka të ngritura njësi të posaçme kryesore: Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë (KPSSC) dhe Komisioni Përhershëm i Kurrikulës etj. Njëkohësisht, në nivel njësie kryesore, funksionon Dega e Sigurimit të Cilësisë (DSC) e cila bashkëpunon me KPSSC dhe NJSBC në UT për sigurimin e cilësisë. NJSBC mbikëqyr, analizon dhe rekomandon rregullimet e nevojshme në kuadër të rishikimit të programeve të studimit sipas përcaktimeve të Kodit të Cilësisë dhe Standardeve të cilësisë në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë.<br>Në përfundim të çdo semestri, të gjithë studentët e UT-së plotësojnë pyetësorët në lidhje me vlerësimin e pedagogut për çdo lëndë dhe për programet e studimeve. Pyetësorët bëhen në mënyrë konfidenciale. Me përfundimin e plotësimit të pyetësorëve, përpunohen të dhënat e vlerësimit për çdo pedagog lënde. Pyetësori për vlerësimin e pedagogut përbën një ndër indikatorët më të rëndësishëm për vlerësimin e performancës së pedagogut. Informacioni i grumbulluar përpunohet me qëllim vlerësimin e mësimdhënies dhe cilësinë e programeve të studimeve.<br><br>*Evidenca nr. 2 – Statuti i Universitetit të Tiranës ;*<br><br>*Evidenca nr. 3 – Rregullorja e Universitetit të Tiranës ;*<br><br>*Evidenca nr. 4 – Strategjia e Zhvillimit të Universitetit të Tiranës 2018 – 2023;*<br><br>*Evidenca nr. 6 – Strategjia institucionale për mësimdhënien Universiteti i Tiranës 2022 – 2027;*<br><br>*Evidenca nr. 34 - Vendim Rektorati, nr.3, datë 24.01.2022, për miratimin në parim të Rregullores "Mbi vlerësimin e performancës në punë të personelit ndihmës akademik dhe administrativ në UT";*<br><br>*Evidencë nr. 39 – Model Pyetësori i Studentit;*<br><br>*Evidencë nr. 40 - "Vendim nr.43, datë 07/12/2020 "Për emërimin e anëtarëve të KPSSC".* |
| **Kriteri 3.** Institucioni i arsimit të lartë përdor | GVJ konstaton se institucioni ka përdorur metodologji dhe instrumente vlerësimi për ecurinë dhe mbarëvajtjen e |

| | |
|---|---|
| metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve. | programeve të studimit përfshirë edhe programin e studimit "Master Profesional European Business Laë". KPSSC, përdor në realizim të misionit të saj metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve dhe e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë.<br><br>*Evidenca nr. 2 – Statuti i Universitetit të Tiranës ;*<br><br>*Evidenca nr. 3 – Rregullorja e Universitetit të Tiranës ;*<br><br>*Evidenca nr. 4 – Strategjia e Zhvillimit të Universitetit të Tiranës 2018 – 2023;*<br><br>*Evidenca nr. 6 – Strategjia institucionale për mësimdhënien Universiteti i Tiranës 2022 – 2027;*<br><br>*Evidenca nr. 34 - Vendim Rektorati, nr.3, datë 24.01.2022, për miratimin në parim të Rregullores "Mbi vlerësimin e performancës në punë të personelit ndihmës akademik dhe administrativ në UT";*<br><br>*Evidencë nr. 39 – Model Pyetësori i Studentit.* |
| **Kriteri 4.** Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit. | GVJ bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB konstaton se mekanizmat dhe metodologjitë vlerësuese konsistojnë në relacione dhe raporte vlerësimi mbi të dhënat e pyetësorëve të studentëve, pyetësorët e pedagogëve, kalendarët e kontrollit, relacionet semestrale, përmbushja e programit të lëndëve duke pasqyruar problemet e konstatuara, takimet periodike të studentëve me departamentet dhe DSC. Të dhënat e grumbulluara përpunohen nga personat përgjegjës dhe më pas i bëhen të ditura Përgjegjësit së Departamentit të së Drejtës Penale, Publike, Civile dhe Dekanit/es.<br><br>*Evidenca nr. 4 – Strategjia e Zhvillimit të Universitetit të Tiranës 2018 – 2023;*<br><br>*Evidenca nr. 6 – Strategjia institucionale për mësimdhënien Universiteti i Tiranës 2022 – 2027;*<br><br>*Evidenca nr. 34 - Vendim Rektorati, nr.3, datë 24.01.2022, për miratimin në parim të Rregullores "Mbi vlerësimin e performancës në punë të personelit ndihmës akademik dhe administrativ në UT";*<br><br>*Evidencë nr. 39 – Model Pyetësori i Studentit.* |
| **Kriteri 5.** Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionin e siguruar nga vizita në institucion, GVJ |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë | konstaton se UT për aktivitetet e monitorimit dhe të vlerësimit të ecurisë dhe mbarëvatjes së programeve të studimit harton raporte të cilat përmbajnë rezultatet e vlerësimit për adresimin e mangësive të identifikuara dhe rekomandimet përkatëse për përmirësimin e tyre.<br>*Evidenca nr. 4 – Strategjia e Zhvillimit të Universitetit të Tiranës 2018 – 2023;*<br>*Evidenca nr. 6 – Strategjia institucionale për mësimdhënien Universiteti i Tiranës 2022 – 2027;*<br>*Evidenca nr. 34 - Vendim Rektorati, nr.3, datë 24.01.2022, për miratimin në parim të Rregullores "Mbi vlerësimin e performancës në punë të personelit ndihmës akademik dhe administrativ në UT";*<br>*Evidencë nr. 39 – Model Pyetësori i Studentit.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| | |
|---|---|
| **Standardi VI.3**<br>**Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.** | |
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike. | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitave në institucion, GVJ konstaton se UT realizon vlerësimin e brendshëm periodik të programeve të studimit nëpërmjet metodave të tërthorta dhe të drejtpërdrejta. Një instrument shumë efektiv i përdorur nga FDUT është përfshirja e studentëve në proceset e vlerësimit të programit të studimit "Master Profesional European Business Laë" si në rastin e përbërjes së GVB ku një përfaqësues është student i programit të studimit.<br>Përvoja e fundit e fituar nga UT gjatë hartimit të raportit të vlerësimit të brendshëm në 2018 në kuadër të akreditimit, ka shërbyer si një përvojë pozitive edhe për metodikën e punës |
| **Kriteri 2**. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të | por edhe për të formalizuar gjithë instrumentet e posaçme për vlerësimin e programit të studimit: Manualin e Sigurimit të Cilësisë, Manualin e Vlerësimit të Performancës të Personelit Akademik, Rregullorja "Mbi vlerësimin e |

| | |
|---|---|
| përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit. | performancës në punë të personelit ndihmës akademik dhe administrativ në Universitetin e Tiranës si dhe njësi kryesore për mbikëqyrjen e këtij procesi: Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë (KPSSC), Komisioni i Kurrikulës në rang universiteti dhe Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe e Karrierës në rang fakulteti.<br><br>*Evidenca nr. 4 – Strategjia e Zhvillimit të Universitetit të Tiranës 2018 – 2023;*<br>*Evidenca nr. 6 – Strategjia institucionale për mësimdhënien Universiteti i Tiranës 2022 – 2027;*<br>*Evidenca nr. 34 - Vendim Rektorati, nr.3, datë 24.01.2022, për miratimin në parim të Rregullores "Mbi vlerësimin e performancës në punë të personelit ndihmës akademik dhe administrativ në UT";*<br>*Evidencë nr. 39 – Model Pyetësori i Studentit.*<br>*Evidenca 62 – Komisioni i përhershëm për sigurimin e standardeve të cilësisë, Vendim Nr. 10, Datë 11.04.2019 i Senatit Akademi*<br>*Evidenca 40 – Manuali i sigurimit të cilësisë UT.* |
| **Kriteri 3.** Institucioni i arsimit të lartë, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda të drejtpërdrejta, si: vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera. | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion, GVJ konstaton se në kuadër të vlerësimit të reaizimit, mbarëvajtjes e cilësisë të programit të studimit Master Profesional European Business Law" DSC e NJSBC kanë përdorur metoda të drejtpërdrejta si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies përmes monitorimit të silabuseve nga zyra e sigurimit të brendshëm të cilësisë, vlerësim të didaktikës përmes vlerësimit të stafit akademik nga kolegë me tituj, si dhe përmes vlerësimeve paralele të provimeve apo detyrave të studentëve.<br>*Evidenca nr. 2 – Statuti i Universitetit të Tiranës ;*<br>*Evidenca nr. 3 – Rregullorja e Universitetit të Tiranës ;*<br>*Evidenca nr. 4 – Strategjia e Zhvillimit të Universitetit të Tiranës 2018 – 2023;*<br>*Evidenca nr. 6 – Strategjia institucionale për mësimdhënien Universiteti i Tiranës 2022 – 2027;*<br>*Evidenca nr. 34 - Vendim Rektorati, nr.3, datë 24.01.2022, për miratimin në parim të Rregullores "Mbi vlerësimin e performancës në punë të personelit ndihmës akademik dhe administrativ në UT";*<br>*Evidencë nr. 39 – Model Pyetësori i Studentit.* |
| **Kriteri 4.** Institucioni i arsimit të lartë, në kuadër të | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga institucioni dhe nga vizita dhe intevitat e kryera, GVJ |

| | |
|---|---|
| vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program. | konstaton se në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes dhe cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të personelit akademik, ndihmës-akademik e administrativ me qëllim përmirësimin e cilësisë. Pyetësorët dhe fokus grupet realizohen me studentët në baza periodike ku dy herë në vit zhvillohen pyetësorë dhe një herë në vit fokus grupe.<br>*Evidenca nr. 2 – Statuti i Universitetit të Tiranës ;*<br>*Evidenca nr. 3 – Rregullorja e Universitetit të Tiranës ;*<br>*Evidenca nr. 4 – Strategjia e Zhvillimit të Universitetit të Tiranës 2018 – 2023;*<br>*Evidenca nr. 6 – Strategjia institucionale për mësimdhënien Universiteti i Tiranës 2022 – 2027;*<br>*Evidenca nr. 27 – Informacion i detajuar mbi takimet dhe aktivitetet e zhvilluara nga Fakulteti i Drejtësisë, UT ;*<br>*Evidenca nr. 34 - Vendim Rektorati, nr.3, datë 24.01.2022, për miratimin në parim të Rregullores "Mbi vlerësimin e performancës në punë të personelit ndihmës akademik dhe administrativ në UT";*<br>*Evidencë nr. 39 – Model Pyetësori i Studentit.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi VI.4**<br>**Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informaciot të siguruar gjatë vizitave, GVJ konstaton se UT ka hartuar dhe garanton që në zbatimin e politikave dhe procedurave të brendshme të cilësisë të përfshihen aktorë të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit Master Profesional European Business Law".<br>*Evidenca nr. 2 – Statuti i Universitetit të Tiranës ;*<br>*Evidenca nr. 3 – Rregullorja e Universitetit të Tiranës ;* |

<table>
<tr><td></td><td>Evidenca nr. 4 – Strategjia e Zhvillimit të Universitetit të Tiranës 2018 – 2023;</td></tr>
<tr><td>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</td><td rowspan="2">GVJ konstaton se UT ka përcaktuar përgjegjësi dhe detyra konkrete për KPSSC mbështetetur në Statutin e UT-së. komisioni. KPSSC përcakton përgjegjësitë dhe detyrat e gjithë strukturave (stafi akademik e ndihmës i departamentit, fakulteti, njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë, komisionet e posaçme) apo individëve (shefi i departamentit, dekani) që marrin pjesë në procesin e sigurimit të cilësisë së programit të studimit, përfshirë edhe studentët. Në procesin e sigurimit të cilësisë garantohet përfshirja e aktorëve të brendshëm (stafi akademik, ndihmës e studentët) pa dallim e diskriminim dhe në respekt të integritetit akademik.<br><br>Evidenca nr. 2 – Statuti i Universitetit të Tiranës ;<br>Evidenca nr. 3 – Rregullorja e Universitetit të Tiranës ;<br>Evidenca nr. 4 – Strategjia e Zhvillimit të Universitetit të Tiranës 2018 – 2023;<br>Evidenca nr. 5 – Plani i kërkimit shkencor të Universitetit të Tiranës 2018 – 2022 ;<br>Evidenca nr. 6 – Strategjia institucionale për mësimdhënien Universiteti i Tiranës 2022 – 2027;<br>Evidenca nr. 34 - Vendim Rektorati, nr.3, datë 24.01.2022, për miratimin në parim të Rregullores "Mbi vlerësimin e performancës në punë të personelit ndihmës akademik dhe administrativ në UT";<br>Evidencë nr. 39 – Model Pyetësori i Studentit;<br>Evidencë nr. 40 - "Vendim i Senatit Akademik nr.10, datë 11.04.2019 "Për miratimin e KPSSC të Universitetit të Tiranës";<br>Evidencë nr. 41 - "Manuali i vlerësimit të performancës së personelit akademik të Universitetit të Tiranës".</td></tr>
<tr><td>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit.</td></tr>
<tr><td>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</td><td>Në respekt të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", gjatë procedurave që kryhen nga strukturat përkatëse të sigurimit të cilësisë për vlerësimin e programit të studimit, respektohet integriteti akademik, etika dhe liria akademike. Të gjithë pyetësorët që kryhen me studentët në mënyrë periodike janë të tilla që ruajnë anonimatin dhe konfidencialitetin e tyre.</td></tr>
</table>

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Kriteri 5**. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj | Rezulton që në aspektin e aktivizimit si pjesë e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë të aktorëve të jashtëm, kryhet Panairi i Karrierës i organizuar nga UT ku marrin pjesë subjekte publike dhe private. Gjithashtu është organizuar dhe "Java e Europës në Universitetin e Tiranës". Gjithashtu mobilitetet Erasmus/+ kanë ndihmuar në këtë proces.<br><br>Bazuar në dokumentacion që GVJ-së i është vënë në dispozicion nga GVB konstatohet se UT ka përfshirë dhe aktivizuar personel të brendshëm dhe të jashtëm me eksperiencë si pjesë e NJSBc-së, KPSSC-së dhe GVB-ve të fakulteteve si dhe përfaqësues të studentëve. Këta aktorë janë pjesëmarrës aktivë të procesit të vlerësimit të brendshëm të institucionit dhe të programeve të studimit.<br><br>*Evidenca nr. 2 – Statuti i Universitetit të Tiranës ;*<br>*Evidenca nr. 3 – Rregullorja e Universitetit të Tiranës ;*<br>*Evidenca nr. 4 – Strategjia e Zhvillimit të Universitetit të Tiranës 2018 – 2023;*<br>*Evidenca nr. 6 – Strategjia institucionale për mësimdhënien Universiteti i Tiranës 2022 – 2027;*<br>*Evidencë nr. 39 – Model Pyetësori i Studentit;*<br>*Evidencë nr. 40 - "Vendim i Senatit Akademik nr.10, datë 11.04.2019 "Për miratimin e KPSSC të Universitetit të Tiranës";*<br>*Evidencë nr. 41 - "Manuali i vlerësimit të performancës së personelit akademik të Universitetit të Tiranës".* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi VI.5**<br><br>**Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të SBC për | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB, GVJ konstaton se UT ka hartuar dhe zbaton politika dhe stategji trasparente për organizimin dhe aktivitetet në kuadër të sistemit të brendshëm të cilësisë, përfshirë edhe programin |

| | |
|---|---|
| programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit. | e studimit Master Profesional European Business Laë" dhe ka bërë publike një pjesë të tyre në faqen zyrtare të institucionit (P.sh Statuti i UT).<br><br>GVJ konstaton se nga FD nuk janë bërë publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit aktivitetet në kuadër të sistemit të SBC për programin e studimit.<br><br>*<u>GVJ rekomandon</u> që FD të bëjë publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit aktivitetet në kuadër të sistemit të SBC për programin e studimit.*<br><br>*Evidenca nr. 2 – Statuti i Universitetit të Tiranës ;*<br><br>*Evidenca nr. 3 – Rregullorja e Universitetit të Tiranës ;*<br><br>*Evidenca nr. 4 – Strategjia e Zhvillimit të Universitetit të Tiranës 2018 – 2023;*<br><br>*Evidencë nr. 40 - "Vendim i Senatit Akademik nr.10, datë 11.04.2019 "Për miratimin e KPSSC të Universitetit të Tiranës"* |
| **Kriteri 2.** Institucioni i arsimi të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale. | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB, GVJ konstaton se KPSSC përgatit raportet vjetore periodike për procesin mësimor dhe adreson rekomandime. Rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit "Master Profesional European Business Laë" janë ndarë më grupet e interesit. GVJ konstaton se nuk janë bërë publike të dhënat e rezultateve të vlerësimit të programit të studimit duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.<br><br>*Evidenca nr. 2 – Statuti i Universitetit të Tiranës ;*<br><br>*Evidenca nr. 32 - URDHËR Nr.12 datë 08.6.2015 i Rektoratit të UT-së : Mbi Miratimin e Rregullores "Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në Universitetin e Tiranës"* |
| **Kriteri 3.** Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara. | GVJ kontaton se bazuar në informacionet e marra gjatë intervistave dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion, pas nxjerrjes së rezultateve të vlerësimit janë ndërmarrë masa për të arritur objektivin e përmirësimit të angësive të identifikuara. Disa nga masat e marra në drejti të përmirësimit të cilësisë janë trajnimet e vazhdueshme mbi metodat e mësimdhënies dhe kërkimin shkencor.<br><br>*Evidenca nr. 25 "Krijimi i Qendrës Virtuale të Trajnimit nëUT – Vendim i Senatit UT, nr.48";* |

| | |
|---|---|
| | *Evidenca nr.25"Trajnimet e ofruara nga Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit në Universitetin e Tiranës";*<br><br>*Evidenca nr.27 "Informacion i detajuar mbi takimet dhe aktivitetet e zhvilluara nga Fakulteti i Drejtësisë".* |
| **Kriteri 4.** Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit. | GVJ konstaton se UT ka vlerësuar dhe siguron monitorim të vazhdueshëm të procesit të vlerësimit dhe përmirësimit të cilësisë të "Master Profesional European Business Law". Ky proces vlerësimi dhe monitorimi ka objektiv sigurimin e efektivitetit të masave të marra për përmirësimin e mangësive dhe problematikave të identifikuara gjatë procesit të vlerësimeve periodike dhe siguron përirësimin e cilësisë të programit të studimit.<br><br>*Evidenca nr. 2 – Statuti i Universitetit të Tiranës ;*<br><br>*Evidenca nr. 3 – Rregullorja e Universitetit të Tiranës ;*<br><br>*Evidenca nr. 4 – Strategjia e Zhvillimit të Universitetit të Tiranës 2018 – 2023;*<br><br>*Evidencë nr. 40 - "Vendim i Senatit Akademik nr.10, datë 11.04.2019 "Për miratimin e KPSSC të Universitetit të Tiranës"* |
| **Kriteri 5.** Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit | Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB, GVJ konstaton se UT ka përfshirë stafin akademik dhe studentët në proceset e informimit e ndërgjegjësimit të tyre për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit nëpërmjet:<br>- pjesëmarrjes së tyre ne GVB-të ad hoc të programeve të studimit në process akreditimi;<br>- në ditët e informimit në fillim të vitit akademik;<br>- dhe në mënyrë të tërthortë me pyetësorët drejtuar studentëve;<br><br>Por nuk ka realizuar veprimtari trajnuese dhe informuese për këtë qëllim.<br><br>*<u>GVJ rekomandon</u> që UT të organizojë veprimtari trajnuese dhe informuese me personelin akademik dhe studentët për ti informuar për nevojën e ndërgjegjësimit dhe pjesëmarrjn aktive në proceset e sigurimit të cilësisë dhe përmirësimit të vazhdueshëm.*<br><br>*Evidenca nr. 2 – Statuti i Universitetit të Tiranës ;*<br><br>*Evidenca nr. 3 – Rregullorja e Universitetit të Tiranës ;*<br><br>*Evidenca nr. 4 – Strategjia e Zhvillimit të Universitetit të Tiranës 2018 – 2023;* |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në: EU Business Law**

**a. Pikat e forta dhe afirmime:**

1. Personel akademik me përvojë akademike dhe profesionale të konsiderueshme, jetëgjatësi në institucion, me kualifikime të kategorisë "Lektor" dhe "Profesor";
2. Raporti i mbulimit të programit të studimit me personel akademik efektiv në masën mbi 70% të totalit të orëve;
3. Angazhimi i lartë në aktivitetet shkencore të organizuar nga institucioni të personelit akademik;
4. Infrastruktura në funksion të programit të studimit;
5. Rrjeti i gjërë i marrëveshjeve të bashkëpunimit të institucionit me partënerë të fushës akademike dhe të biznesit;
6. Fonde të parashikuara për projekte kërkimore shkencore;
7. Kurrikul inovative në përputhje me kërkesat e tregut;

**b. Pika të dobta:**

1. Mospërputhje e shpërndarjes se kategorive formuese dhe syllabuseve të programit të studimit në përputhje me VKM Nr. 41, datë 24.01.2018; ***(Standardi II.3,kriteri 2); (Standardi II.1,kriteri 6)***
2. Nuk ka të parashikuar në kurrikul lëndën e "praktikës profesionale" sipas VKM Nr. 41, datë 24.01.2018; ***(Standardi III.2, kriteri 7)***

**Rekomandime**

1. Të rishikohet shpërndarja e lëndëve në planin mësimor të programit të studimit, sipas kategorive të veprimtarive formuese (A - E), dhe syllabuset e programit, në përputhshmëri me aktet ligjore në fuqi (VKM Nr. 41, datë 24.01.2018);
2. Të parashikohet futja në planin mësimor të lëndës "Praktikë Profesionale";
3. Të pasurohet biblioteka me të gjithë literaturën ndihmëse si dhe literaturë të natyrës së ngjashme me lëndët që zhvillohen në programin e studimit. Gjithashtu në bibliotekë duhet të ketë një fond të vecantë fizik dhe elektronik të literaturës ndihmëse apo leksioneve të shkruara nga pedagogët e lëndës;
4. Rekomandohet të bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit aktivitetet në kuadër të sistemit të SBC për programin e studimit;
5. Rekomandohet të organizohen veprimtari trajnuese dhe informuese me personelin akademik dhe studentët për ti informuar për pjesëmarrjen aktive në proceset e sigurimit të cilësisë dhe përmirësimit të vazhdueshëm;
6. Rekomandohet të bëhet një shpërndarje më e mirë në planin mësimor të % midis njohurive teorike dhe praktike duke i dhënë më shumë peshë orëve të seminareve në përputhje me ciklin e dytë të studimeve;

**Conclusions of the evaluation of the second program Professional Master in: EU Business Law**

**a. Strengths and Affirmations:**

1. Academic personnel with considerable academic and professional experience, longevity in the institution, with "Lecturer" and "Professor" category qualifications;
2. The coverage ratio of the study program with effective academic personnel to the extent of over 70% of the total hours;
3. High commitment to the scientific activities organized by the academic staff institution.
4. Infrastructure in function of the study program;
5. The institution's wide network of cooperation agreements with academic and business partners;
6. Anticipated funds for scientific research projects;
7. Innovative curriculum in line with market requirements.

**b. Weak points:**

*1.* Inconsistency of the formative categories of the syllabuses of the study program based in VKM (Council of Ministers decision) No. 41, dated 24.01.2018; ***(Standard II.3, criterion 2); (Standard II.1, criterion 6)***

2. It is not foreseen in the curricula the subject of "Professional Practice" according to VKM No. 41, dated 24.01.2018; ***(Standard III.2, criterion 7)***

**Recommendations**

1. The library should be enriched with all the auxiliary literature as well as literature of a similar nature to the subjects developed in the study program. Also, the library should have a special physical and electronic fund of auxiliary literature or lectures written by the lecturers of the subject;
2. It is recommended to reinstate the management system and enrich this system with other items besides the exam results;
3. It is recommended that the activities within the SBC system for the study program be made public for students and all interested parties;
4. The University of Tirana to organize training and information activities with academic staff and students to inform them about the need for awareness and active participation in quality assurance and continuous improvement processes;
5. It is recommended to make a better distribution in terms of % between theoretical and practical knowledge, giving more weight to seminar hours in accordance with the second cycle of studies.

**Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

| FUSHAT E VLERËSIMIT | SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Nuk përmbushen | Përmbushen pjesërisht | Përmbushen kryesisht | Përmbushen plotësisht |
| I. OFRIMI, I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT | | | | X |
| II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT | | | | X |
| III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT | | | | X |
| IV. BURIMET NJERËZORE, FINANACIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT | | | | X |
| V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE | | | | X |
| VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE | | | | X |
| VLERËSIMI TËRËSOR | | | | X |